



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 404 Akti

Nr. 456 Vendimi
Tiranë, më 8.10.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bektashi	Kryesuese
Firdes Shuli	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në datat 6.10.2021 dhe 8.10.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Irena Hoxha**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Hoxha, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Irena Hoxha është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethi Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Irena Hoxha do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Suela Zhegu, Firdes Shuli dhe Brunilda Bekteshi. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.

3. Për këtë subjekt rivlerësimi u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Me vendimin nr. 1, datë 24.12.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Irena Hoxha, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Brunilda Bekteshi. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti nuk u shpreh mbi ndonjë gjendje konflikti interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Me vendimin nr. 2, datë 17.9.2021, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin profesional, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

6. Në datën 21.9.2021, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, jo më vonë se data 4.10.2021; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 4.10.2021, subjekti i rivlerësimit dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e saj në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ kryesisht.

8. Pas shqyrtimit të shpjegimeve e provave të vëna në dispozicion nga subjekti, me vendimin nr. 3, datë 4.10.2021, trupi gjykues vendosi kalimin në seancë dëgjimore.

9. Në datën 6.10.2021 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

10. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

11. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

12. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

13. Referuar vendimit nr. 2/201721 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

Vlerësimi i pasurisë

14. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit Irena Hoxha ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë në datën 24.1.2017, pra në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit Irena Hoxha është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2004, me nr. indeksi *** dhe ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private në vijim.

15. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Irena Hoxha ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarin të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

16. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklaratimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

17. Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklaratimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklaratimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

18. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: *“Tokë bujqësore me sip. 8075 m², në të cilën përfshihet 100 m² truall, ku është ndërtuar shtëpi në vitin 1953 (e paregjistruar në regjistrat publikë). Akti i marrjes së tokës në pronësi me nr. *** regj.”*. Nuk është deklaruar pjesa takuese dhe vendndodhja¹ e kësaj pasurie.

Hetimi i Komisionit

19. Sa i takon statusit të kësaj pasurie, rezultoi se:

19.1 ASHK-ja Dibër² informoi se shtetasi H. H. H. ka të regjistruar në z. k. K., Dibër, pasuritë e paluajtshme: truall me sip. 100 m², me nr. pasurie ***; tokë arë me sip. 1400 m², me nr. pasurie ***; dhe tokë arë me sip. 6575 m², me nr. pasurie ***.

19.2 ASHK-ja³ nuk ka konfirmuar ndonjë aplikim për vetëdeklarimin e ndonjë objekti informal për përfshirje në procesin e legalizimeve.

19.3 FSHU-ja⁴ nuk ka konfirmuar kontratë të furnizimit me energji në emër të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit (N. H.) apo vjehrrit të saj H. H. në Dibër. Subjekti ka informuar se për këtë banesë është lidhur kontrata e furnizimit me energji elektrike nr. ***, në emër të babait të bashkëshortit H. H. H., kontratë e cila është mbyllur në maj të vitit 2016, ndërkohë që nuk ka kontratë të furnizimit me ujë, pasi nuk ka rrjet të ujësjellës-kanalizimeve⁵.

20. Në lidhje me origjinën, mënyrën e krijimit dhe deklaratimet e subjektit, nga aktet e administruara⁶ rezultoi se:

¹Kjo pasuri është deklaruar në vijim edhe nga babai i bashkëshortit të subjektit H. H., 100 % në pronësi të tij, me vendndodhje në K., Dibër.

²Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 16.6.2020, nga ASHK-ja Dibër, në dosjen e Komisionit.

³Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 22.5.2020, nga ASHK-ja, në dosjen e Komisionit.

⁴Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.5.2020, nga FSHU-ja, në dosjen e Komisionit.

⁵Shihni mandatarkëtimin nr. ***, datë 30.8.2019, sipas të cilit vërtetohen pagesa deri në maj të vitit 2016, bashkëlidhur me përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

⁶Shihni aktet në aneksin nr. 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 1 në dosjen e Komisionit.

20.1 Sipas aktit të marrjes së tokës në përdorim nr. *** (pa datë), familjes së shtetasit H. H. nga fshati K., Dibër, i është dhënë në pronësi tokë arë me sip. 8075 m², ku përfshihet edhe 100 m² tokë truall.

20.2 Me anë të vërtetimit të datës 15.10.2016, të ZVRPP-së Dibër, vërtetohet se shtetasi H. H. ka të regjistruar në z. k. *** (K., Dibër) tokë bujqësore me sip. 8075 m², në të cilën përfshihet edhe truall me sip. 100 m².

20.3 Në deklarinimin para fillimit të detyrës, dorëzuar në datën 17.3.2004, subjekti ka deklaruar si pasuri të trashëguar pasurinë truall, me sip. 100 m², pjesa takuese 25 %, me nr. pasurie ***, e trashëguar; tokë arë me sip. 1400 m², me nr. pasurie ***, e trashëguar; dhe tokë arë me sip. 6575 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, fshati V., Dibër.

20.4 E pyetur gjatë procesit se përse në deklaratën *Vetting* vendndodhja e kësaj pasurie deklarohet fshati K., Dibër, ndërsa në deklarinimin për vitin 2003 deklarohet me vendndodhje në fshatin V., Dibër, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se bëhet fjalë për të njëjtën pasuri, por zona kadastrale quhet K., Dibër, ndërsa fshati quhet V., territor i cili është nën juridiksionin e Njësisë Administrative K., Bashkia Dibër.

20.5 E pyetur në lidhje me deklarinimin e vitit 2003, sipas të cilit është deklaruar se është bashkëpronare në këtë pasuri të trashëguar, subjekti ka deklaruar se ka qenë një lapsus, si rezultat i perceptimit të gabuar të ligjit në momentin e plotësimit të deklaratës së parë, lapsus të cilin e ka rregulluar në deklaratën *Vetting*, ku nuk ka deklaruar pjesë takuese të kësaj pasurie, pasi pronarë të saj të vetëm janë bashkëshorti dhe prindërit e tij, duke i vërtetuar këto deklarime me vërtetimin nr. *** prot., datë 17.1.2020, lëshuar nga ASHK-ja Dibër.

21. Në lidhje me përdorimin e kësaj pasurie, në përgjigjet e pyetësorëve nr. 1 dhe nr. 2, subjekti ka deklaruar se nga viti 1996 e deri në fund të vitit 2001 familja e saj (ajo, bashkëshorti, tre fëmijët, vjehri dhe vjehra) kanë banuar në këtë banesë, e cila ka qenë ndërtuar nga vjehri i saj mbi truallin me sip. 100 m² që në vitin 1953, të paregjistruar në regjistrat publikë. Në vitin 2001 janë larguar për në Peshkopi⁷, por kjo banesë është përdorur deri në vitin 2016 për periudha të shkurtra gjatë vitit për arsye familjare, me qëllim shfrytëzimin e tokës bujqësore, kryesisht gjatë fundjavës dhe pushimeve. Mbi këtë banesë nuk është kryer asnjë investim përgjatë këtyre viteve, por vetëm është mirëmbajtur nga vëllai i bashkëshortit që të mos dëmtohej nga kushtet atmosferike. Prej vitit 2016 është bërë e pabanueshme, fakt i vërtetuar edhe me informacionin e OSHEE-së, sipas të cilit pagesat e kryera për energjinë elektrike janë deri në maj të vitit 2016. Për të vërtetuar pretendimin e saj, subjekti ka paraqitur foto, nga e cila banesa duket e vjetër, por jo e rrënuar.

22. Në përfundim të hetimit administrativ u vërtetua se pasuria, objekt shqyrtimi, është deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, ndonëse në momentin e plotësimit të saj subjekti nuk ka qenë as pronarë/bashkëpronarë dhe as përdorues e pasurisë dhe se mbi të nuk vërtetohen investime. Nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë pasuri.

23. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “Pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “apartament”, me sip. 76 m², në Peshkopi. Akt noterial nr. ***, datë 14.11.2001. Burimi

⁷Në këtë vit familja e subjektit ka blerë pasurinë apartament në Peshkopi.

i krijimit: të ardhurat nga toka dhe pagat për vitet 1991 - 2001. Vlera: 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: 25 %”.

Hetimi i Komisionit

24. Në lidhje me statusin aktual të kësaj pasurie, gjatë hetimit administrativ rezultoi se:

24.1 ASHK-ja Dibër⁸ informoi se znj. Irena Hoxha ka të regjistruar në bashkëpronësi me shtetasit N., H. dhe N. H. pasurinë e llojit “apartament”, me sip. 76 m², z. k. ***, në Peshkopi.

24.2 FSHU-ja⁹ nuk konfirmoi kontratë të furnizimit me energji në emër të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit N. H. apo vjehrrit të saj H. H. në Peshkopi. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se kontratat e furnizimit me energji dhe ujë të kësaj banese janë në emër të bashkëshortit të saj N. H., përkatësisht me nr. *** dhe nr. ***. Pas kërkesës së Komisionit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti vërtetoi këto fakte me: (i) shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.6.2021, nga FSHU-ja; dhe (ii) vërtetimin nr. *** prot., datë 27.1.2020, nga UKT-ja Dibër.

25. Në lidhje me origjinën e mënyrën e krijimit, si dhe përdorimin e kësaj pasurie, nga dokumentet e administruara¹⁰ rezultoi se:

25.1 Sipas aktit noterial nr. ***, datë 14.11.2001, shtetasi H. H. (vjehri i subjektit) ka blerë nga shtetasit U. dhe J. H. apartamentin me sip. 76 m² në qytetin e Peshkopisë, në çmimin 1.000.000 lekë. Sipas kartelës së pasurisë, pasuria nr. *** është e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve H., I., N. dhe N. H. në datën 19.11.2001.

25.2 Në deklarinimin para fillimit të detyrës të vitit 2004, subjekti ka deklaruar: *“Apartament banimi 2+1, me sip. 67 m², me vlerë 1.00.000 lekë, pjesa takuese: 25 %. Adresa: pallati nr. ***, hyrja ***, lagjja ‘Gj. D.’, Peshkopi, me nr. pasurie ***. Burimi i krijimit: të ardhurat personale (familjare)”.*

25.3 Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se ka banuar në këtë apartament nga momenti i emërimit në detyrë në datën 16.3.2004 dhe deri më 15.11.2011, kur është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, fakt që konfirmohet edhe në DPV-të e viteve 2003 - 2011, ku subjekti ka deklaruar si adresë banimi adresën e kësaj pasurie, ndërsa në deklarinimet e viteve në vijim e ka deklaruar si adresë vendqëndrimi tjetër.

25.4 Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka informuar se pas vitit 2012 kjo banesë është përdorur nga familja e saj, kryesisht prindërit e bashkëshortit dhe fëmijët, gjatë muajve qershor - shtator dhe nuk është dhënë në përdorim të personave të tretë, vërtetuar me faturat e konsumit të energjisë elektrike për vitet 2013 - 2020, ku konsumi i energjisë elektrike në këto muaj është më i lartë.

26. Në DPV-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar se ka përfiturar të ardhura nga dhënia me qira e këtij apartamenti për periudhën 1.1.2012 – 31.12.2012, në shumën 300.000 lekë. Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti se deklaruar dhe ka vërtetuar se është paguar tatimi mbi të

⁸Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 16.6.2020, nga ASHK-ja Dibër, në dosjen e Komisionit.

⁹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.5.2020, nga FSHU-ja, në dosjen e Komisionit.

¹⁰Shihni aktet në aneksin nr. 4/1 dhe nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së, si dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 1, në dosjen e Komisionit.

ardhurat nga qiratë¹¹. Sipas çmimeve të referencës një apartament banimi në Peshkopi, për atë periudhë, do të jepej me qira mujore në shumën 10.596 lekë¹², ndërkohë që është dhënë 25.000 lekë/muaj. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me rrethanat në të cilat kjo qira mujore ka qenë rreth 2.5 herë më e lartë se vlera e referencës. Në parashtrimet e saj subjekti ka sqaruar se në qytetin e Peshkopisë, pas hapjes së filialit të universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, kërkesa për shtëpi me qira u rrit, prandaj vlera e saj ka qenë në këtë shumë. Përveç kësaj, zona në të cilën ndodhet ky apartament banimi është shumë e kërkuar edhe sot. Sipas saj, vlera e qirasë prej 25.000 lekësh është vlera e tregut të qirasë në atë zonë. Duke qene se filiali i universitetit “Aleksandër Moisiu” në Peshkopi është hapur në vitin akademik 2009 - 2010¹³, edhe pse ky apartament është dhënë me qira më të lartë se sa çmimi i referencës, Komisioni çmoi ta vlerësojë të drejtë pretendimin e subjektit dhe të marrë të mirëqenë qiranë e deklaruar në DPV-në e vitit 2010, duke e konsideruar si të ardhur të ligjshme.

27. Në lidhje me justifikimin e kësaj pasurie me të ardhura të ligjshme, janë analizuar burimet e deklaruara nga subjekti, edhe pse pasuria është blerë në vitin 2001, pra para se subjekti të jetë bërë subjekt deklarues (viti 2004).

Burimi i të ardhurave nga pagat për periudhën 1991 – 2001

27.1 Në analizën financiare është konsideruar që subjekti dhe familja e saj kanë jetuar së bashku me prindërit e bashkëshortit, fakt të cilin subjekti e ka deklaruar në DPV-të ndër vite dhe në deklaratën Vetting, vërtetuar edhe nga certifikata familjare, datë 25.1.2020¹⁴, nga e cila rezulton se përbërja e saj familjare është me 7 persona: ajo, bashkëshorti, prindërit e tij dhe tre fëmijët e tyre. Bazuar në dokumentacionin e administruar, të ardhurat nga pagat e subjektit dhe bashkëshortit, si dhe pensionet e prindërve të tij¹⁵ për periudhën 1991 – 2001, janë në shumën 3.318.217 lekë¹⁶.

Burimi i të ardhurave nga toka për periudhën 1991 – 2001

27.2 Në lidhje me burimin e tyre u vërtetua se:

27.2.1 Vjehri i subjektit, si përfaqësues i familjes bujqësore, ka pasur në pronësi tokë arë, me sip. 8075 m² (trajtuar më sipër).

27.2.2 Në deklaratën Vetting, vjehri i subjektit ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore për periudhën 1992 – 2006, në shumën 1.100.000 lekë.

27.2.3 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se nga viti 1996, kur është martuar, deri në fund të vitit 2001, ajo dhe familja e saj ka jetuar në fshatin V., Bashkia Dibër, dhe se nga përdorimi i tokës bujqësore janë marrë çdo vit të ardhura nga prodhimet bujqësore, blegtorale dhe të frutikulturës për konsum familjar (të ardhura në natyrë) dhe jo për tregti, të

¹¹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.1.2017, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, sipas të cilës në datën 10.1.2017 është paguar tatimi mbi qiranë në shumën 45.000 lekë.

¹²Në bazë të vendimit nr. ***, datë 3.6.2015, të DPT-së, vlera e qirasë për m², është 0.3 % e vlerës së shitjes së këtij apartamenti. Bazuar në udhëzimin nr. 4, datë 23.11.2011, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja” vlera e shitjes së një apartamenti në qytetin e Peshkopisë për vitin 2012 është 46.472 lekë.

¹³Referuar VKM-së nr. ***, datë 5.8.2009.

¹⁴Shihni përgjigjen e pyetjes nr. 3 të pyetësorit standard.

¹⁵Vërtetimet nr. ***, datë 25.10.2016 dhe nr. ***, datë 14.10.2016, nga ISSH-ja, për pension pleqërie të shtetasit H. H.; vërtetimet nr. ***, datë 25.10.2016 dhe nr. ***, datë 14.10.2016, nga ISSH-ja për pension pleqërie të shtetasës N. H..

¹⁶Këtu janë përfshirë të ardhurat e subjektit nga viti i martesës 1996, pagat e bashkëshortit të subjektit nga viti 1995, si dhe pensionet e prindërve të bashkëshortit nga viti 1991.

cilat në vlerë monetare arrijnë në shumën 200.000 lekë/vit. Për të vërtetuar pagimin e taksës së tokës, subjekti ka paraqitur: (i) vërtetimin nr. ***, datë 24.9.2019, lëshuar nga Bashkia Peshkopi, sektori i taksave dhe tarifave vendore; si dhe (ii) vërtetimin nr. *** prot., datë 6.7.2021, të Njesisë Administrative K..

27.2.4 E pyetur më tej në lidhje me legjitimitetin e të ardhurave nga toka bujqësore, në përgjigje të pyetëorit nr. 3, subjekti paraqiti përgjigjen e Drejtorisë së Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave pranë Bashkisë Dibër¹⁷, sipas të cilës të ardhurat konkrete për periudhën 1992 – 2001 janë në total në shumën 4.536.000 lekë. Duke qenë se të dhënat e kësaj shkrese nuk i janë referuar ndonjë evidence të kohës pasi është e paqartë si janë përlllogaritur të ardhurat nga kjo tokë bujqësore, në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhura nga toka bujqësore.

27.3 Nga analiza financiare, pasqyruar si në tabelën në vijim, duket se subjekti, bashkëshorti dhe familja e tij, kanë pasur të ardhura të ligjshme për të blerë pasurinë, objekt shqyrtimi, në vitin 2001.

Përshkrimi	Periudha 1991 – 2001
Pasuri	1 000 000
Apartament banimi 2+1, me sip. 76 m ² , në Peshkopi, blerë më 14.11.2001	1 000 000
Të ardhura	3 318 217
Të ardhura nga pagat e subjektit	1 446 533
Të ardhura nga pagat e bashkëshortit	1 418 344
Të ardhura nga pagat e vjehrrit	379 104
Të ardhura nga pagat e vjehrrës	74 236
Shpenzime	2 188 098
Shpenzime jetese sipas përbërjes familjare	1 622 610
Mundësia për kursime	695 607

27.4 Sa i takon shpenzimeve jetike, duke qenë se subjekti ka jetuar së bashku me familjen në fshatin V. deri në vitin 2001 dhe ka provuar se familja e bashkëshortit ka pasur tokë bujqësore, shpenzimet e jetesës për periudhën 1991 – 1999 janë konsideruar në masën 50 % të të ardhurave familjare. Për vitet 2000 dhe 2001 është përdorur standardi i ILDKPKI-së, sipas përbërjes familjare për 5 dhe 6 persona, përkatësisht duke u reduktuar këto shpenzime në masën 47.6 %¹⁸. Në të njëjtën masë janë reduktuar shpenzimet e jetesës së subjektit dhe familjes së saj deri në fund të vitit 2003, për shkak se është bërë subjekt deklarues në vitin 2004.

27.5 Në përfundim të hetimit administrativ nuk kanë rezultuar problematika në lidhje me këtë pasuri.

28. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “*Pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, Tiranë. Akti noterial nr. ***, datë 3.11.2010. Burimi i krijimit: kursime nga pagat, përkatësisht: për vitin 2006 – vlera 600.000 lekë; për vitin 2007 – vlera 800.000 lekë; për vitin*

¹⁷Shihni shkresën nr. *** prot., datë 22.7.2021, nga Bashkia Dibër, Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

¹⁸Anketa e Buxhetit të Familjes është realizuar nga INSTAT-i për herë të parë në Shqipëri për vitin 2006 – 2007, i cili është viti më i afërt me vitet 2000 dhe 2001. Sipas kësaj ankete ushqimi (pa përfshirë pijet alkoolike) mbetet një element i rëndësishëm në buxhetin familjar, duke zënë 47.6 % të tij. Në këtë grup, peshën më të madhe e zë shpenzimi për “mish dhe nënprodukte” që përbën rreth 22.5 % të buxhetit brenda grupit. Produktet që vijnë më pas për nga vlera e shpenzuar janë “qumështi, vezët dhe nënproduktet e tij” (me një peshë prej 16.1 %), si dhe “bukë dhe drithëra” (15.5 %). Nëngrupet që vijnë më pas janë perimet, që zënë 14 % të grupit kryesor dhe frutat që zënë 8.8 %.

2008 – vlera 1.200.000 lekë; për vitin 2009 – vlera 700.000 lekë; për vitin 2010 – vlera 1.200.000 lekë. Kontrata e huas nr. ***, datë 3.11.2010, vlera 60.000 euro. Vlera: 12.032.000 lekë. Pjesa takuese: 25 %”.

29. ILDKPKI-ja, në lidhje me këtë pasuri, ka konstatuar:

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin financiar të huamarrjes në shumën 60.000 euro, nga shtetasi P. H. H. (vëllai i bashkëshortit të subjektit), pasi nga konfirmimet rezulton se ky shtetas nuk ka mundësi financiare ose aktivitete private me të cilat të ketë krijuar të ardhurat për shumën e dhënë hua.
- Mungesë burimi të ligjshëm financiar për blerjen e apartamentit me sip. 102.4 m², të ndodhur në Tiranë, në vlerën 12.032.000 lekë, në vitin 2010.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e përfituara nga toka me sip. 8075 m², në Dibër, e lënë në përdorim, të deklaruara si burim për blerjen e apartamentit me sip. 102.4 m², në Tiranë, në deklaratën e interesave private periodike/vjetore të vitit 2010.
- Mosdeklarim në deklaratën e interesave private periodike/vjetore të vitit 2010 të pakësimit të gjendjes *cash* për periudhën 2006 – 2010, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit me sip. 102.4 m², të ndodhur në Tiranë.

Hetimi i Komisionit

30. Në lidhje me statusin e kësaj pasurie, rezultoi se:

30.1 ASHK-ja, Tirana Veri¹⁹, ka konfirmuar të regjistruar në emër të shtetasit N. H. H. apartamentin me sip. 102.4 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***.

30.2 FSHU-ja dhe UKT-ja nuk kanë konfirmuar kontrata furnizimi me energji dhe ujë. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka vërtetuar se për këtë apartament në emër të shtetasit N. H. H. është lidhur kontrata nr. *** e furnizimit me energji dhe kontrata nr. *** e furnizimit me ujë²⁰.

31. Në lidhje me origjinën e mënyrën e krijimit të pasurisë, si dhe likuidimin e çmimit nga aktet²¹ në dosje, rezulton se:

31.1 Sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 22.10.2010, pasuria e llojit “apartament”, me sip. 102.4 m², me nr. ***, është e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve L., A. dhe E. I..

31.2 Shtetasi N. H., me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 1.11.2010, ka blerë nga shtetasit e sipërpërmendur pasurinë nr. ***, kundrejt çmimit 12.032.000 lekë, regjistruar në emër të tij sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 18.11.2010.

31.3 Në DPV-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar blerjen e apartamentit me anë të kësaj kontrate me të njëjtën vlerë, por pa deklaruar burimin e krijimit.

31.4 E pyetur gjatë procesit në lidhje me mënyrën e likuidimit të çmimit të blerjes së pasurisë, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka informuar se likuidimi i çmimit prej 12.032.000

¹⁹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.8.2020, nga ASHK-ja, Tirana Veri, në dosjen e Komisionit.

²⁰Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.6.2021, lëshuar nga FSHU-ja dhe autorizimi për debitim direkt për UKT-në për abonentin me kontratë nr. ***.

²¹Shihni aktet në aneksin nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentacioni bashkëlidhur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.8.2020, nga ASHK-ja, Tirana Veri, në dosjen e Komisionit.

lekësh nga bashkëshorti i saj N. H. është bërë në të njëjtën ditë me lidhjen e kontratës, një pjesë nëpërmjet “Intesa Sanpaolo Bank” në llogarinë e shitëses L. I., në dy derdhje 29.000 euro dhe 44.000 euro, dhe pjesa tjetër prej 14.000 euro i është paguar *cash* tre bashkëpronarëve. Për të vërtetuar këto pretendime subjekti ka paraqitur: (i) mandatarkëtimin me referencë nr. ***, datë 1.11.2010; dhe (ii) mandatarkëtimin me referencë nr. ***, datë 1.11.2010. Ndërsa për pagimin e shumës prej 14.000 euro subjekti ka deklaruar se nuk disponon ndonjë dokument tjetër përveç kontratës së shitjes.

Në lidhje e trajtimit e mundshëm preferencial

32. Sipas udhëzimit nr. 3, datë 3.2.2010, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2010”, për zonën 7/2, ku ndodhet apartamenti, çmimi në tregun e lirë për vitin 2010 është 117.500 lekë/m². Pra, referuar çmimit të referencës, apartamenti i blerë do të kushtonte $102.4 \text{ m}^2 \times 117.500 \text{ m}^2 = 12.032.000$ lekë, ndërkohë që ka kushtuar 12.032.000 lekë. Vërehet se bashkëshorti i subjektit e ka blerë pasurinë me çmim reference.

Analizë e burimeve të krijimit të pasurisë

33. Burimi i deklaruar: *kursime nga pagat, përkatësisht: për vitin 2006 – 600 000 lekë; për vitin 2007 – 800 000 lekë; për vitin 2008 – 1 200 000 lekë; për vitin 2009 – 700 000 lekë; për vitin 2010 – vlera 1 200 000 lekë.* Nga verifikimi i DPV-ve ndër viteve u konstatua se:

33.1 Në DPV-në e vitit 2006 deri në vitin 2010, subjekti ka deklaruar këtë gjendje të likuiditeteve *cash* ndër vite: për vitin 2006 – shumën 600.000 lekë; për vitin 2007 – shumën 800.000 lekë; për vitin 2008 – shumën 950.000 lekë; për vitin 2009 – shumën 700.000 lekë; dhe për vitin 2010 – shumën 1.200.000 lekë. Deklarimi i gjendjes *cash* është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën si më poshtë vijon:

Vitet	Shuma e deklaruar në deklaratën <i>Vetting</i> (në lekë)	Shuma e deklaruar sipas DPV-ve (në lekë)	Gjendja e likuiditeteve në fund të çdo viti, bazuar në DPV (në lekë)
2006	600 000	600 000	600 000
2007	800 000	800 000	1 400 000
2008	1 200 000	950 000	2 350 000
2009	700 000	700 000	3 050 000
2010	1 200 000	1 200 000	4 250 000

33.2 E pyetur në lidhje me mënyrën e deklarimit të likuiditeteve *cash* dhe gjendjen e tyre në fund të çdo viti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se në DPV-të e çdo viti ka deklaruar shtesa të gjendjes *cash*²². Nisur nga formati i deklaratës së interesave private periodike/vjetore, i cili kërkon deklarimet e shtesave/pakësimeve të gjendjeve *cash*, si dhe faktit që subjekti ka deklaruar në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha DPV-të shumën e deklaruar në fund të çdo viti, janë konsideruar shtesa të gjendjeve *cash* nga viti i kaluar, ashtu sikurse subjekti pretendon.

33.3 Duke qenë se ka mospërputhje në deklarimet e gjendjes *cash* në DPV-në e vitit 2008, me deklarimin në deklaratën *Vetting*, u pyet subjekti, e cila në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ka deklaruar: “[...] Në DPV-në e vitit 2008 janë gjendje 1.200.000 lekë, vlerë e cila vjen nga

²²Trajtuar hollësisht në paragrafët 63 dhe 64 të këtij vendimi.

950.000 lekë të ardhura cash nga pagat dhe 250.000 lekë të ardhura cash nga shitja e automjetit me targa ***. Progresive 2008, vlera e akumuluar 2.600.000 lekë”. Nga verifikimi i DPV-së së vitit 2008 rezulton se subjekti ka deklaruar gjendje cash në shumën 950.000 lekë dhe në të njëjtën rubrikë ka deklaruar: “E ardhur nga shitja e makinës (kontrata e shitjes nr. ***, datë 15.2.2008), shuma 250.000 lekë”. Siç vërehet, subjekti ka deklaruar shumën 250.000 lekë si të ardhur në fund të vitit 2008 dhe jo si gjendje cash, ndërkohë që nëse kjo shumë nuk do të ishte shpenzuar që prej datës 15.2.2008 duhet të ishte deklaruar si shtesë e gjendjes cash në fund të këtij viti. Duke konsideruar si provë DPV-në e vitit 2008, ku shtesa e këtij viti është deklaruar në shumën 950.000 lekë, në përfundim të hetimit administrativ kjo shumë është konsideruar si e ardhur e ligjshme në analizën financiare për blerjen e apartamentit.

33.4 Në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar shtesë të gjendjes cash prej 1.200.000 lekësh, nga e cila shuma 200.000 lekë ka qenë me burim të ardhura nga toka në përdorim. Meqenëse subjekti nuk ka provuar pagesë tatimi mbi këtë të ardhur të deklaruar si një vlerë monetare, pjesë përbërëse e shtesës së likuiditetit në cash, kjo shumë nuk është konsideruar si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit më 1.11.2010²³.

33.5 Përveç sa më sipër, subjekti nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2010 si burim²⁴ “pakësim të gjendjes cash” dhe as pakësim të gjendjeve cash, por e ka korrigjuar në deklaratën Vetting, ku ka deklaruar në mënyrë analitike krijimin dhe akumulimin e gjendjes cash deri në vitin 2010. Duke ballafaquar gjendjen cash vit pas viti me atë të deklaruar në deklaratën Vetting, rezulton se shuma 4.250.000 lekë është akumuluar deri në fund të vitit 2010, nga e cila vetëm shuma 4.050.000 lekë²⁵ është konsideruar të jetë përdorur për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi.

34. Burimi i deklaruar: *kontrata e huas nr. ***, datë 3.11.2010, vlera: 60.000 euro*. Në lidhje me këtë kontratë dhe huadhënësin P. H., rezultoi se:

34.1 Shtetasi N. H. (bashkëshorti i subjektit), me kontratën e huas nr. ***, datë 3.11.2010²⁶, i ka marrë hua shtetasit P. H. (vëllai i tij) vlerën 60.000 euro, pa interes, për një periudhë 12-vjeçare, e cila fillon nga data 1.11.2010, datë në të cilën kjo shumë i është dorëzuar huamarrësit. Sipas kontratës, kthimi i huas do të bëhet me këste prej 5.000 euro në fund të çdo viti, deri në likuidimin e plotë të shumës së marrë hua.

34.2 E pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi mënyrën e kalimit të shumës prej 60.000 euro nga shtetasi P. H., në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka informuar se kjo shumë i është marrë dorazi në datën 1.11.2010 nga bashkëshorti i saj, vëllait të tij P. H.. Ndërsa më tej, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, ka informuar se të ardhurat e realizuara nga emigracioni nga ky shtetas janë sjellë prej tij fizikisht herë pas here. Subjekti ka vënë në dispozicion edhe fotokopje të disa faqeve të pasaportës së shtetasit P. H., nga ku duket se ka pasur hyrje-dalje ndër vite nga Greqia në Shqipëri dhe anasjelltas.

²³Trajtuar hollësisht në paragrafët 63 dhe 64 të këtij vendimi.

²⁴Në DPV-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e pasurisë apartament vetëm huan prej 60.000 euro.

²⁵Kjo shumë është diferenca e gjendjes cash të akumuluar deri në fund të vitit 2010 në shumën 4.250.000 lekë, duke zbritur shumën 200.000 lekë me burim “të ardhura nga toka bujqësore e lënë në përdorim”.

²⁶Shihni aktet në aneksin nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

34.3 Nga verifikimi në sistemin *TIMS* ka rezultuar se shtetasi P. H. nuk ka qenë në Shqipëri në datën 3.11.2010²⁷. E pyetur mbi këtë konstatim, në përgjigjet e saj të datës 14.9.2021, dërguar me *e-mail*, subjekti ka deklaruar se shtetasi P. H. ka qenë në Shqipëri në datën 3.11.2010, kur është nënshkruar kontrata. Sipas saj, ky shtetas është larguar nga Shqipëria për në Republikën e Maqedonisë (sot Maqedonia e Veriut) nëpërmjet pikës kufitare B., në datën 29.9.2010 dhe ka hyrë në territorin shqiptar nga e njëjta pikë kufitare në datën 12.10.2010. Po kështu, në datën 10.11.2010 shtetasi P. H. ka udhëtuar vajtje-ardhje brenda ditës në Republikën e Maqedonisë. Për të vërtetuar deklaratimet e saj subjekti ka paraqitur dokumentet, si vijon: (i) shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2021, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, e cila tregon hyrjet-daljet në kufi të shtetasit P. H.; si dhe (ii) kopje të disa fletëve të pasaportës së këtij shtetasi, ku evidentohen vulat e hyrjes dhe daljes të përshkruara më sipër.

34.4 Për sa më sipër, vërtetohet që shtetasi P. H. H. ka qenë në Shqipëri në datën 3.11.2010, datë kur është nënshkruar kontrata prej tij.

34.5 Nga verifikimet e kryera në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi apo përfshirje të tij në veprimtari të krimit të organizuar, nuk ka rezultuar që subjekti të ketë shqyrtuar çështje ku palë pjesëmarrëse në proces të ketë qenë shtetasi P. H.²⁸, dhe as procedime penale apo pasurore të regjistruara në emër të tij²⁹.

Në lidhje me të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer si burim për dhënien e huas nga shtetasi P. H., në cilësinë e personit tjetër të lidhur

35. Në pyetësin standard subjekti ka informuar se burimi i të ardhurave për dhënien e huas prej 60.000 euro janë të ardhura të huadhënësit P. H. nga emigracioni në Greqi prej vitit 1992. Për të vërtetuar këto të ardhura subjekti ka paraqitur “pasqyrat e likuidimit tatimor mbi të ardhurat e personit fizik në bazë të deklaratimit fillestar”³⁰, të deklaruara në organet përkatëse tatimore të shtetit grek për vitet 2001 - 2010, nga analiza e të cilave konstatohet se gjatë kësaj periudhe ky shtetas ka pasur të ardhura në shumën 76.450 euro³¹.

36. Duke qene se: (i) në DPV-në e vitit 2010 subjekti nuk e ka deklaruar huan si burim për blerjen e pasurisë; (ii) nuk u vërtetua që personi tjetër i lidhur të ketë depozituar në ndonjë llogari bankare të ardhurat e tij në shtetin grek të fituara vit pas viti që prej 2001-it deri në 2010-ën; (iii) nuk u vërtetua kalimi i shumës prej 60.000 euro në rrugë bankare në llogari të bashkëshortit të saj; (iv) të ardhurat në shtetin grek të huadhënësit u pretendua të jetë sjellë pjesë-pjesë dorazi nga huadhënësi sa herë vinte në Shqipëri; (v) si burim i huas prej 60.000 euro u pretenduan të jenë edhe të ardhurat nga bujqësia ndër vite të huadhënësit, u bë e domosdoshme të kryhej një analizë financiare e huadhënësit, me qëllim verifikimin e mundësive të tij për të krijuar me të ardhura të ligjshme shumën e dhënë hua prej 60.000 euro, ashtu sikurse e kërkon pika 4 e nenit 32 e ligjit nr. 84/2016.

²⁷Shtetasi P. H. ka dalë nga Shqipëria në datën 29.9.2010, në pikën kufitare B. dhe është kthyer në territorin shqiptar nga e njëjta pikë kufitare në datën 10.11.2010.

²⁸Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.8.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 6.8.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

²⁹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 3.8.2021, nga SPAK-u, në dosjen e Komisionit.

³⁰Ky dokument është analog me deklaratën DIVA; ai është detyrim të dorëzohet në Zyrën e Tatimeve DOY për çdo shtetas dhe rezident në shtetin grek, i cili ka mbushur moshën 18 vjeç dhe përfiton çdo lloj të ardhure në këtë shtet (<http://www.odigostoupoliti.eu/forologiki-dilosi/>).

³¹Nga kjo shumë nuk janë zbritur shpenzimet e jetesës së familjes së tij, e cila përbëhet nga 5 persona, bashkëshortja dhe 3 fëmijë.

37. Për efekt të një analize financiare të huadhënësit sa më afër realitetit, Komisioni i kërkoj informacion dhe dokumente shkresore subjektit të rivlerësimit gjatë gjithë procesit në lidhje me: (i) të ardhura të tjera të ligjshme të huadhënësit P. H.; (ii) mënyrën se si janë përballuar shpenzimet e jetesës së tij dhe familjes për periudhën 2001 – 2010, kur është dhënë huaja; si dhe (iii) investimet e kryera prej tij gjatë kësaj periudhe.

38. Sipas informacioneve të dërguara me përgjigjet e pyetësorit nr. 3 dhe atyre të dërguara në rrugë elektronike në datën 13.8.2021, ka rezultuar se:

38.1 Huadhënësi ka pasur të ardhura në shtetin grek në shumën totale 76.450 euro³², sipas dokumenteve të paraqitura edhe në pyetësorin standard.

38.2 Huadhënësi ka pasur të ardhura nga punimi i tokës bujqësore, me sip. 8075 m², në pronësi të babait të tij dhe vjehrrit të subjektit H. H.³³, të cilat, sipas shkresës nr. *** prot., datë 22.7.2021, lëshuar nga Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Bashkia Dibër, kanë qenë në shumën 4.951.000 lekë. Sipas subjektit kjo shumë është ndarë mes familjes së tij dhe huadhënësit P. H., në bazë të përkushtimit ndaj punimit të tokës dhe nevojave që kishte secili. Konkretisht, deklarohet se të ardhurat nga toka të përfituara nga familja e shtetasit P. H. janë diferenca midis shumës prej 4.951.000 lekësh, me të ardhurat nga toka të deklaruara nga subjekti në DPV-të ndër vite prej 850.000 lekësh. Pra, sipas subjektit të ardhurat nga toka bujqësore e shtetasit P. H. nga punimi i tokës së babait të tij janë në vlerën 4.101.000 lekë, duke pretenduar që kjo shumë duhet të merret në konsideratë si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të huadhënësit.

38.3 Huadhënësi ka pasur të ardhura nga përdorimi i tokës arë, me sip. 1000 m², e cila ndodhet në fshatin V., në pronësi të tij, përfitur me AMTP-në nr. ***, sipas ligjit nr. 7501³⁴, me vlerë 1.610.000 lekë, sipas shkresës nr. ***, datë 30.7.2021, të Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Bashkia Dibër.

38.4 Është paguar taksa e tokës për tokat bujqësore në pronësi, si më sipër, të huadhënësit P. H. dhe vjehrrit të saj H. H., vërtetuar me vërtetimin nr. ***, datë 24.9.2019, lëshuar nga Bashkia Peshkopi, sektori i taksave dhe tarifave vendore, dhe vërtetimin nr. *** prot., datë 6.7.2021, të Njesisë Administrative K..

38.5 Bashkëshortja e huadhënësit, S. R. H.³⁵, ka pasur të ardhura të përfituara nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Peshkopi, për periudhën 2002 – 2010, si dhe pension invaliditeti nga shtatori i vitit 2003 e në vijim. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur dokumente³⁶ të cilat provojnë pagesat e sigurimeve shoqërore si të vetëpunësuar në bujqësi të shtetasit P. H. nga viti 1993 deri sot

³²Kjo shumë përbëhet nga pagat e shtetasit P. H. në shumat 76.186 euro dhe 260.85 euro nga kthimi i taksave të rezultuara nga "pasqyra e likuidimit tatimor mbi të ardhurat e personit fizik në bazë të deklaramit fillestar", nga Zyra e Tatim-Taksave në Greqi.

³³Vërtetuar me AMTP-në nr. ***, të këtij shtetasi.

³⁴Vërtetuar me vërtetimin nr. ***, datë 21.7.2021, lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Dibër, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. ***; vërtetim datë 2.8.2021, lëshuar nga ASHK-ja Dibër, dhe certifikatë për vërtetim pronësie lëshuar në datën 5.2.2004, nga ZVRPP-ja Dibër, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit të datës 30.7.2021, në dosjen e Komisionit.

³⁵Vërtetim nr. *** prot., datë 15.7.2021, lëshuar nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Dibër, Agjencia Peshkopi; vërtetim nr. *** prot., datë 15.7.2021, lëshuar nga Njësia Administrative K., Bashkia Dibër.

³⁶Vërtetim nr. ***, datë 15.7.2021, për të vetëpunësuarin në bujqësi, shtetasin P. H. H., lëshuar nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Dibër, Agjencia Peshkopi; vërtetim nr. ***, datë 15.7.2021, për të vetëpunësuarin në bujqësi, shtetasin S. R. H., lëshuar nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Dibër, Agjencia Peshkopi.

dhe bashkëshortes së tij S. H. nga viti 1993 deri në 2003-in (vit të cilin ka përfituar pension invaliditeti).

38.6 Sa i takon shpenzimeve të jetesës, subjekti ka deklaruar se familja e huadhënësit ka jetuar në fshatin V., Dibër, dhe se ai vetë jetonte me periudha të caktuara në Greqi. Subjekti ka dhënë informacion edhe për ditët e qëndrimit në Greqi të shtetasit P. H. për efekt të përlogaritjes së shpenzimeve të jetesës së tij në këtë shtet, shoqëruar me disa faqe të pasaportës të tij, ku evidentohen hyrje-daljet në shtetin grek dhe anasjelltas, si dhe ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, të datës 21.7.2021, në të cilën ky shtetas deklaroi se ka punuar në shtetin grek nga viti 1992 deri në 1997-ën pa dokumente dhe nga viti 1998 deri në 2012-ën me dokumente të rregullta. Nga të dhënat e sistemit *TIMS* dhe pasaportës së shtetasit P. H. është provuar se pas vitit 2000 huadhënësi ka jetuar midis Greqisë dhe Shqipërisë dhe shpenzimet e tij të jetesës janë përlogaritur në bazë të ditëve të qëndrimit të tij në shtetet përkatëse.

38.7 Sa i takon investimeve të tjera të kryera nga huadhënësi gjatë periudhës së analizuar 2001-2010, subjekti ka informuar se:

38.7.1 Huadhënësi P. H. disponon një shtëpi banimi të ndërtuar para vitit 1991 në fshatin V., Dibër, në proces legalizimi, data e vetëdeklarimit 20.11.2018, si dhe ka paraqitur vërtetimin nr. *** kërkesë, datë 2.8.2021, të ASHK-së Dibër dhe foto të ndërtesës, ku banesa duket e rinovuar. E pyetur për investimet e kryera për rinovimin e saj dhe periudhat, duke i vërtetuar me dokumentacion, në përgjigjet e saj të datës 14.9.2021, subjekti ka deklaruar se banesa është rinovuar në vitet 2014 - 2015 dhe se shpenzimi është në shumën 1.300.000 lekë. Subjekti ka paraqitur: (i) preventiv për punimet e banesës; dhe (ii) ortofoto të viteve 2007 dhe 2015, nga të cilat duket se kjo banesë është e parinovuar në vitin 2007 dhe e rinovuar në vitin 2015. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në të dhënat që dispononte, Komisioni çmoi të konsiderojë që investimi në këtë pasuri prej huadhënësit P. H. është kryer jashtë periudhës së analizuar 2001 – 2010 dhe, për rrjedhojë, nuk është përfshirë si shpenzim në analizën financiare të kryer për të, në cilësinë e personit tjetër të lidhur.

38.7.2 Huadhënësi P. H. disponon pasurinë truall me sip. 300 m² dhe ndërtesë me sip. 100 m², me nr. ***, në fshatin Sh., Tiranë, në bashkëpronësi me vëllain P. H., blerë në vitin 2000. Sipas subjektit, kjo ndërtesë është prishur në vitin 2005 dhe mbi këtë truall, po në vitin 2005, është ndërtuar kati përdhes, ndërsa në vitin 2013 është ndërtuar kati i parë. Subjekti informon se aktualisht banesa është vetëm karabina dhe në proces legalizimi. Për të vërtetuar pretendimet, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore³⁷. Me tej, në përgjigjet e datës 14.9.2021, subjekti ka deklaruar se kati përdhes është ndërtuar nga të dy vëllezërit në vitin 2005 dhe se vlera e investimit për këtë kat është rreth 1.100.000 lekë, ku secili prej tyre ka investuar gjysmën e vlerës. Sa i takon burimit të të ardhurave për pjesën e shpenzimit nga shtetasi P. H., janë të ardhurat nga puna si emigrant ekonomik në Greqi para viteve 2000, për të cilat nuk disponon dokumentacion. Për ndërtimin e katit përdhes ka deklaruar se kanë shërbyer materialet e banesës ekzistuese (tulla), ndërsa fuqia punëtore është përballuar nga të dy bashkëpronarët. Sipas subjektit, kati i parë i ndërtesës karabina është ndërtuar nga kunati P. H.

³⁷Certifikatë për vërtetim pronësie, lëshuar në datën 21.7.2000, nga ZVRPP-ja Tiranë; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 20.4.2000, për blerjen e pasurisë truall, me sip. 300 m² dhe ndërtesë me sip. 100 m², në vlerën 1.500.000 lekë; shkresë datë 5.8.2021, nga ASHK-ja, Tirana Rurale 2, për përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimit informal me nr. *** prot., datë 30.1.2015, në Njësinë nr. 6, Tiranë, nga shtetasi P. dhe P. H.; foto të ndërtesës karabina.

në vitin 2013, pra jashtë periudhës së analizuar. Në mbështetje të deklaramëve të saj, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore³⁸.

38.7.3 Në përfundim të hetimit administrativ, sa i takon periudhës së ndërtimit të objektit, për shkak të mungesës së të dhënave, Komisioni çmoi të marrë në konsideratë deklaramët e subjektit, duke konsideruar që kati përdhes është ndërtuar në vitin 2005 nga shtetasi P. H. dhe vëllai i tij P. H., ndërsa kati i parë në vitin 2013 prej shtetasit P. H. (jashtë periudhës së analizës 2001 – 2010). Sa i takon investimit të kryer nga shtetasi P. H., dokumentet shkresore të paraqitura nga subjekti nuk vërtetojnë vitet kur është ndërtuar kjo banesë, si dhe investimet reale të kryera mbi të, pasi në preventivin e paraqitur që mban vulën e shoqërisë “R. S.” sh.p.k. nuk evidentohet koha e përpilimit të tij. Nga verifikimet e kryera në faqen zyrtare të QKB-së rezulton se kjo shoqëri është regjistruar në datën 21.2.2011, çka krijon bindjen që kjo planimetri është hartuar kohët e fundit për efekt të procesit të rivlerësimit. Në lidhje me këtë konstatim, në parashtrimet e saj subjekti ka deklaruar se inxhinieri që ka ndjekur punimet e ndërtimit ka qenë administrator në dy shoqëri të ndryshme dhe se ka qenë një pakujdesi që në aktet planimetri dhe preventiv janë përdorur atributet e shoqërisë “R. S.” sh.p.k. të krijuar në vitin 2011 dhe jo të shoqërisë “D. K.” sh.p.k., e cila është krijuar në vitin 1994. Bashkëlidhur subjekti ka paraqitur disa dokumente për këto dy shoqëri³⁹.

38.7.4 Për efekt të përllogaritjes së shpenzimeve të kryera nga shtetasi P. H. gjatë periudhës 2001 – 2010, sa i takon vlerës së ndërtimit të katit përdhes, në mungesë të të dhënave për investimet e kryera, Komisioni është bazuar në çmimet për m² për sipërfaqe ndërtimi të EKB-së për vitin 2005, për qytetin e Tiranës. Vlera e investimit e përllogaritur është sip. $146.68^{40} \text{ m}^2 \times 25.168^{41} \text{ lekë/m}^2 = 3.716.684 \text{ lekë}$. Kjo vlerë është ponderuar me 44.4 %⁴², e cila përfaqëson volumin e punimeve sipas fazës së karabinasë të katit përdhes⁴³, pra, në shumën $3.716.684 \times 44.4\% = 1.650.208 \text{ lekë}$ dhe ½ e kësaj shume është përfshirë si shpenzim i vitit 2005 në analizën financiare të huadhënësit. Në bazë të kontratës së shitblerjes së tokës me nr. ***, datë 20.4.2000, vlera e blerjes së tokës prej 1.500.000 lekësh nuk është përfshirë si shpenzim, pasi është jashtë periudhës së analizës së huadhënësit.

38.7.5 Huadhënësi P. H. disponon një automjet tip “Honda”, me vlerë 1.000 euro, aktualisht me targa ***, blerë në vitin 2008 në Greqi, për të cilin ka paraqitur dokumente shkresore⁴⁴. Vlera e blerjes prej 1.000 euro së këtij automjeti në Greqi është përfshirë si shpenzim në analizën financiare të huadhënësit.

³⁸Planimetri e katit përdhes, katit të parë dhe preventiv zbatimi; fotografimet ajrore të pasurisë, gjendja në vitin 2007 dhe në vitin 2015 ndërtimi të katit parë në vitin 2013 (ortofoto e viteve 2007 dhe 2015). Nga ortofotot nuk arrihet të dallohet ndryshim i ndërtesës nga vitet 2007 dhe 2015.

³⁹Certifikatë regjistrimi të subjektit “D. K.” sh.p.k., me datë regjistrimi 9.3.1994, ekstrakt i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, certifikatë regjistrimi të subjektit “R. S.” sh.p.k. dhe ekstrakt i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”.

⁴⁰Sipërfaqja është nxjerrë nga planimetritë e vëna në dispozicion nga subjekti me përgjigjet e datës 14.9.2021, e cila përbëhet nga sipërfaqja e brendshme 132.3 m², ballkon 6.75 m² dhe shkallët 8.63 m².

⁴¹https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/07/udhzim_5_23.11.pdf

⁴²Shihni dokumentin nr. *** prot., datë 17.5.200, nga Shoqata e Ndërtuesve dhe dokumentin nr. *** prot., datë 17.5.2006, nga Ministria e Financave, “Marrëveshje për përcaktimin e treguesve minimalë për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në ndërtim”.

⁴³Nga fotot e fundit të sjella nga subjekti me e-mail në datën 14.9.2021, duket se e gjithë ndërtesa është ende e papërfunduar.

⁴⁴Faturë për blerje automjeti e datës 5.5.2008; deklaratë zhdoganimi e datës 10.1.2013, dhe kontratë dhurimi i këtij automjeti, me nr. ***, datë 9.1.2013.

38.7.6 Huadhënësi P. H. disponon vlera monetare në shumat 302.021,15 lekë dhe 15.006,37 euro, të depozituara në bankë, vërtetuar me informacionin e BKT-së, të cilat i takojnë periudhës jashtë analizës financiare të tij⁴⁵. Ndërkohë, Komisioni ka kërkuar informacion nga bankat e nivelit të dytë për të gjitha llogaritë dhe depozitat bankare të familjes së shtetasit P. H., nga verifikimi i të cilave ka rezultuar se asnjë nga anëtarët e familjes nuk ka pasur llogari bankare për periudhën e analizuar.

Analizë financiare për të evidentuar nëse huadhënësi ka pasur të ardhura të ligjshme për të mundësuar dhënien e huas prej 50.000 euro

39. Bazuar në provat e administruara, në përfundim të hetimit administrativ është kryer analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve të huadhënësit P. H. për periudhën 2001 – 2010, për të evidentuar mundësinë e tij për të dhënë hua shumë 60.000 euro. Sipas kësaj analize kumulative, pasqyruar në tabelën në vijim, duket se ky shtetas nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të dhënë huan prej 60.000 euro, për shkak të një balance negative prej 3.243.707 lekësh.

Huadhënësi	Vitet 2001 - 2010
Të ardhurat	10 895 588
Të ardhura të dokumentuara nga emigracioni në Greqi (në lekë)	9 703 808
Tatime të rimbursuara në Greqi në lekë	45 015
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	856 365
Pagese invaliditeti nga data 9.2003	290 400
Shpenzimet	14 266 641
Shpenzimet për huadhënësin në Greqi ⁴⁶	2 798 255
Shpenzimet e reduktuara në Shqipëri	2 606 717
Pagesa sigurime shoqërore, P. H.	60 996
Pagesa sigurime shoqërore, bashkëshortja	5 339
Blerë automjet në Greqi, viti 2008	123 183
Investuar për banesën në Sh., Tiranë, viti 2005	825 104
Hua 60.000 euro	7 719 701
<i>Ndryshim likuiditetesh</i>	-
Mundësia për kursime	-3 243 707

40. Në analizën e mësipërme financiare nuk janë përfshirë të ardhurat nga toka bujqësore në pronësi të huadhënësit P. H., si dhe të ardhurat nga toka bujqësore në pronësi të babait të tij H. H., referuar fakteve, si vijojnë: (i) në përmbajtjen e shkresave të përpiluara nga Drejtoria e Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave pranë Bashkisë Dibër, duket se nuk ka të dhëna nëse përlllogaritjet e të ardhurave nga toka bujqësore janë bazuar në ndonjë evidence në kohë reale apo janë bazuar në deklaratimet e subjektit/familjarëve të saj, e për rrjedhojë vlerat e referuara në këto shkresa nuk krijojnë bindjen se janë të ardhura reale të huadhënësit që të kenë shërbyer si burim për krijimin e shumë 60.000 euro; (ii) gjatë gjithë hetimit administrativ subjekti ka deklaruar se të ardhurat nga bujqësia janë të ardhura në natyrë për përdorim vetjak; (iii) ka qenë e paqartë përse, sipas subjektit, një pjesë e të ardhurave nga toka bujqësore në emër të vjehrrit

⁴⁵Shihni konfirmimin e gjendjes së llogarisë nr. *** prot., datë 2.8.2021, dhe konfirmimin e gjendjes së llogarisë nr. *** prot., datë 2.8.2021, lëshuar nga BKT-ja.

⁴⁶Shpenzimet e jetesës në Greqi janë llogaritur në bazë të ditëve të qëndrimit të huadhënësit në këtë shtet, bazuar në të dhëna e Eurostat-it. https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=ilc_li01&lang=en

H. H., dhe pikërisht shuma 4.101.000 lekë, është përfituar vetëm djali i tij, huadhënësi P. H., i cili shkante e vinte në Greqi dhe jo nga dy djemtë e tjerë, të cilët banonin në Shqipëri.

41. Por, duke qenë se huadhënësi P. H. dhe familja e tij për periudhën e qëndrimit në Shqipëri⁴⁷: (i) ka provuar pagesën e taksës së tokës; (ii) nga shkresa e Drejtorisë së Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, pranë Bashkisë Dibrë, duket se toka bujqësore prej 1000 m² në pronësi të tij ka pasur prodhime; (iii) ka paguar sigurime shoqërore si i vetëpunësuar në bujqësi për veten dhe për disa nga vitet edhe për bashkëshorten e tij, shpenzimet e jetesës janë llogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së, duke u reduktuar me shportën e produkteve ushqimore të përlllogaritura nga INSTAT-i. Konkretisht: për vitet 2001 - 2007 është zbritur përqindja e grupit “ushqim” (pa përfshirë pijet alkoolike), i cili zë 47.6 % të buxhetit familjar⁴⁸ dhe për vitet 2008 - 2010 është zbritur përqindja e grupit “për ushqim” me vlerë 57.9 % sipas anketës së matjes së nivelit të jetesës⁴⁹.

Analizë financiare e subjektit për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi

42. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në analizën e burimeve që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë, është kryer analiza financiare për subjektin e rivlerësimit, përmbledhur në tabelën vijuese, ku huaja prej 60.000 euro nuk është konsideruar si burim i ligjshëm, e cila rezulton me një balancë negative prej 7.069.519 lekësh.

	1.11.2010
Pasuri	7 982 000
Apartament me sip. 102.4 m ² , Tiranë, datë 1.11.2010	12 032 000
<i>Shtesa/pakësime, likuiditete</i>	-4 050 000
Të ardhura	1 790 915
Të ardhura nga pagat e subjektit	922 541
Të ardhura nga pagat e bashkëshortit	706 379
Të ardhura nga pagat e vjehrrit	120 575
Të ardhura nga pagat e vjehrrës	41 420
Hua nga shtetasi P. H., 60.000 euro	-
Shpenzime	878 434
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së për 7 persona ⁵⁰	730 844
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	47 590
Shpenzime arredimi	100 000
Mundësia për kursime	-7 069 519

43. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me pasurinë nr. ***, në Tiranë, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve, si vijon: (i) subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë në DPV-në e vitit 2010 sipas ligjit; (ii) duket se subjekti nuk ka justifikuar blerjen e pasurisë me të ardhura të ligjshme, për shkak të një balance negative prej 7.069.519 lekësh.

⁴⁷Gjatë procesit të hetimit administrativ, si dhe në seancën dëgjimore subjekti ka deklaruar se familja e shtetasit P. H. ka banuar gjithmonë në Shqipëri.

⁴⁸Anketa e buxhetit të familjes http://www.instat.gov.al/media/2067/buxheti_i_familjes pdf, sipas të cilës në këtë grup peshën më të madhe e zë shpenzimi për “mish dhe nënprodukte”, që përbën rreth 22.5 % të buxhetit brenda grupit. Produktet që vijnë më pas për nga vlera e shpenzuar janë “qumështi, vezët dhe nënproduktet e tij” (me një peshë prej 16.1 %) si dhe “bukë dhe drithëra” (15.5 %). Nëngrupet që vijnë më pas janë perimet që zënë 14 % të grupit kryesor dhe frutat që zënë 8.8 %.

⁴⁹http://www.instat.gov.al/media/2063/anketa_e_matjes_se_nivelit_te_jeteses_2008 pdf

⁵⁰Për vjehrrin dhe vjehrrën shpenzimet e jetesës janë barazuar me pensionet.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit, bazuar në arsyetimin sipas fakteve dhe ligjit të zbatueshëm

44. Në parashtrimet e saj, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se mosdeklarimi i burimit të krijimit të pasurisë në DPV-në e vitit 2010 ka qenë një pasaktësi, duke menduar se me deklarimin e vlerës së huas dhe shlyerjen e saj çdo vit do të kuptohej dhe ishte e qartë se pjesa tjetër ka qenë me burim kursimet e krijuara ndër vite, për sa kohë këto kursime nuk ishin pakësuar. Subjekti ka sjellë në vëmendje të Komisionit qëndrimin e mbajtur në vendimin nr. ***, sipas të cilit pasaktësitë në DPV-të vjetore të pashoqëruara me dyshime për fshehjen e pasurisë nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore. Përkundër sa pretendon subjekti, Komisioni vlerëson se mosdeklarimi i burimit të krijimit të pasurive në deklaratat vjetore merr një peshë specifike të posaçme në rastet kur pasuria nuk justifikohet me të ardhura të ligjshme, çka krijon premisa për dyshime.

45. Në lidhje me burimin e huas, subjekti ka deklaruar se provohet tej çdo dyshimi që vëllai i bashkëshortit ka krijuar me të ardhura të ligjshme shumën prej 60.000 euro, duke parashtruar si vijon:

45.1 Për vitin 2002, në dokumentin “pasqyra e likuiditeteve tatimore të tatimit mbi të ardhurat”, lëshuar nga autoritetet e shtetit grek, nga ana e përkthyeses është kryer një gabim material. Kështu, në vend të shifrës 1.500.767 dhrahmi (4.404 euro ose 607.320 lekë) ajo ka vendosur shumën 1.501,767 euro (pra, në vend të pikës ka vendosur gabimisht presje) që e konvertuar në lekë është 206.959 lekë. Subjekti ka paraqitur kopje të dokumentit origjinal grek. Sa i takon këtij pretendimi, subjekti ka paraqitur edhe një herë dokumentin ku evidentohet korrigjimi i shumës së saktë, e cila është në dhrahmi dhe jo në euro dhe, për këtë arsye, të ardhurat e këtij viti janë korrigjuar në analizën financiare të rishikuar.

45.2 Për vitet 2009 dhe 2010, bazuar në dokumentin “pasqyra e likuiditeteve tatimore të tatimit mbi të ardhurat”, lëshuar nga autoritetet e shtetit grek, bëhet fjalë për të ardhura të pavarura tatimore⁵¹, pasqyruar në DIVA-n greke, përkatësisht në vlerën 1.923,14 euro, e barasvlershme me 263.767 lekë për vitin 2009 dhe 855,74 euro e barasvlershme me 118.785 lekë për vitin 2010, të cilat, sipas vëllait të bashkëshortit, janë të ardhura të përjashtuara nga taksat dhe janë përfituar në vlerë *neto* prej tij, të cilat quhen *IKA*, të përfituara nga puna në ndërtim, të cilat duhet të përfshihen në analizën financiare.

Sa i takon këtij pretendimi, Komisioni iu referua formularit të deklaratës fillestare DAVP⁵², nga i cili evidentohet se në faqen 3, në rubrikën “tabela 6 – të ardhura shtesë dhe të dhëna të tjera”, kërkohet që të deklarohen të ardhura të tjera, përveç atyre që janë deklaruar në rubrikat e tjera, siç janë “të ardhura të cilat janë të përjashtuara nga tatimi ose taten në mënyrë të veçantë”. Nga kjo rubrikë e formularit të deklarimit të të ardhurave, e cila pasqyrohet edhe në dokumentin “verifikimi i të ardhurave dhe taksave” lëshuar nga Zyra e Tatimeve të Greqisë (DOY)⁵³, ka rezultuar se për vitet 2009 dhe 2010 pasqyrohen të ardhura nga puna dhe të ardhura

⁵¹Përkthimi i saktë do të ishte “të ardhura të përjashtuara nga taksat etj.”.

⁵²https://www.aade.gr/sites/default/files/2021-05/%CE%951_1.pdf

⁵³Deklarata e të ardhurave vjetore personale DAVP është analoge me deklaratën DIVA; ajo është detyrim të dorëzohet në Zyrën e Tatimeve DOY për çdo shtetas dhe rezident në shtetin grek, i cili ka mbushur moshën 18 vjeç dhe përfiton çdo lloj të ardhure në këtë shtet. Pas deklarimit të çdo shtetasi, kjo deklaratë verifikohet për pagesën e saktë të detyrimeve të çdo individit nga DOY (Zyra e Tatimeve), e cila kthen tek deklaruesi dokumentin “Verifikimi i të ardhurave dhe taksave”, sikurse të paraqitura nga subjekti për shtetasin P. H.. Shihni <http://www.odigostoupoliti.eu/forologiki-dilosi/>

të cilat nuk taten. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit për këto vite qëndrojnë, dhe për këtë arsye shumat 1.923 euro dhe 855,74 euro u përfshinë në analizën financiare të rishikuar të huadhënësit.

45.3 Subjekti ka pretenduar që të merren në konsideratë në rubrikën “të ardhura të analizës financiare të huadhënësit”, të ardhurat nga bujqësia dhe blegtoria, përfituar nga toka bujqësore me sip. 1000 m² në pronësi të tij, në vlerën prej 1.600.000 lekësh, si dhe një pjesë nga të ardhurat nga toka bujqësore në pronësi të babait të tij (vjeçrit H. H.) me sip. 7975 m², në vlerën 4.101.000 lekë. Në analizë të këtij parashtrimi, nga njëra anë subjekti pretendon të ardhura në vlerë monetare nga bujqësia e blegtoria dhe nga ana tjetër ka deklaruar dhe vijon të deklarojë se këto toka, ndër vite, janë përdorur për të vjelë prodhime bujqësore dhe blegtorale në natyrë, të cilat kanë shërbyer për jetesë. Në fakt, në ndryshim nga deklaratimet gjatë procesit të rivlerësimit, në parashtrimet e saj subjekti deklaroi se një pjesë e produkteve bujqësore e blegtorale janë tregtuar prej huadhënësit, pasi ka plotësuar nevojat familjare, qëndrim të cilin e mbajti edhe në seancën dëgjimore. Më tej ka parashtruar se familja e bashkëshortit të saj ka mbajtur gjithmonë bletë, produktin e të cilave, pas plotësimit të nevojave familjare, e kanë shitur, aktivitetin e cili vazhdohet edhe sot nga vëllai i bashkëshortit. Sipas subjektit, të ardhurat nga shitja e prodhimeve bujqësore e blegtorale nuk taten, duke iu referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, e duke theksuar se: “... të ardhurat e realizuara nga të vetëpunësuarit në bujqësi apo shitësit ambulante, nuk konsiderohen si të ardhura të tatueshme”. Ndërsa, në pikën 11 të nenit 8/1 të po këtij ligji është parashikuar se: “[...] përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, të ardhurat e realizuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore, apo një person fizik ose juridik që kryen aktivitet bujqësor”. Pavarësisht argumenteve të paraqitura, subjekti nuk paraqiti asnjë dokument shkresor për të vërtetuar të ardhura nga shitja e prodhimeve bujqësore e blegtorale, të ardhura të cilat i pretendoi vetëm pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ.

45.4 Sa i takon informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave pranë Bashkisë Dibër, paraqitur nga subjekt me pyetësin nr. 3, subjekti ka vijuar të pretendojë se vlerat e konfirmuara në këto shkresa janë të ardhura nga produktet bujqësore e blegtorale, dhe për më tepër në kushtet kur është paguar taksa e tokës dhe huadhënësi e bashkëshortja e tij kanë paguar sigurimet shoqërore si të vetëpunësuar në bujqësi, këto të ardhura duhet të konsiderohen në analizën financiare të huadhënësit në masën që ajo ka përlloritur. Bashkëlidhur parashtrimeve, subjekti ka paraqitur:

- shkresat nr. *** prot., dhe *** prot., datë 27.9.2021, nga Njësia Administrative K., Bashkia Dibër, të cilat vërtetojnë pagesën e taksës së tokave për vitet 2003 – 2020, përkatësisht për shtetasit H. dhe P. H.;
- shkresën nr. *** prot., datë 28.9.2021, lëshuar nga Bashkia Dibër, ku shpjegohet metodologjia e llogaritjes së të ardhurave nga toka bujqësore;
- shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2021, lëshuar nga kryeplaku i fshatit V., i cili vërteton se sipërfaqet e tokës janë shfrytëzim nga shtetasit P. dhe N. H. për kultura bujqësore e blegtorale.

45.5 Në analizë të pretendimeve dhe dokumenteve të paraqitura, arsyetohet se:

Së pari, në këto dokumente vazhdohet të jepet informacion se tokat bujqësore janë shfrytëzuar nga huadhënësi P. H. dhe bashkëshorti i subjektit, pa përcaktuar sipërfaqe konkrete të shfrytëzuar nga secili prej tyre.

Së dyti, nga formulimi i shkresave të mëparshme që subjekti kishte paraqitur gjatë hetimit administrativ⁵⁴ ka rezultuar se informacioni për kulturat e mbjella ndër vite (pra struktura e mbjelljeve) është dhënë nga subjekti/familjarët e saj, pra jo nga evidenca të vetë institucionit. Për këtë arsye, me kalimin e barrës së provës, subjektit iu kërkuan të dhëna nëse ka pasur evidenca në kohe reale mbi të cilat janë bazuar të ardhurat e konfirmuara me shkresat e sipërpërmendura, si dhe informacion në lidhje me metodologjinë e përdorur. Në parashtrimet e saj, subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 28.9.2021, lëshuar nga Bashkia Dibër, e cila paraqet metodologjinë e përdorur për përllogaritjen e të ardhurave për secilën nga tokat bujqësore në pronësi të shtetasve H. dhe P. H., metodologji e cila është e bazuar në: (i) bonitetin e tokës bujqësore; (ii) strukturën e mbjelljeve vit pas viti; dhe (iii) në rendimentet mesatare për këto kultura në Njësinë Administratave K., por nuk informon nëse përllogaritjet janë bazuar në evidencat e institucionit të mbajtura në kohë reale. Në këto rrethana, vlerësohet se dokumenti i paraqitur nga drejtoria e pyjeve dhe administrimit të ujerave, është rrjedhojë e kërkesës së subjektit mbi bazë vetëdeklarimi gjatë procesit të rivlerësimit, duke mos provuar të ardhurat reale që mund të jenë përfituar nga shfrytëzimi i tokës, por mundësinë parashikuese të fitimit të tyre, dhe për rrjedhojë, Komisioni çmon se shpjegimet e provat e subjektit për vlerën e të ardhurave reale të perfituara të pretenduara nga subjekti nuk janë bindëse, duke konkluduar se ato nuk duhet të përfshihen në analizën financiare.

Së treti, është e vërtetë që personi tjetër i lidhur ka paguar kontributet për sigurimet shoqërore, por këto pagesa nuk janë provë që tregojnë se personi ka punuar në bujqësi, por janë për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë, që në mënyrë vullnetare mund të paguheshin në çdo kohë nga individët që ishin të interesuar të merrnin pension pleqërie kur nuk plotësonin vitet e punës.

Së katërti, pagimi i taksës së tokës, i cili është një detyrim ligjor për pronarët e tokës bujqësore, nuk vërteton as përdorimin e tokës dhe as përfitimin e të ardhurave nga kjo tokë, të cilat, në rastin e shtetasve H. dhe P. H. rezultojnë të jenë në shumën të konsiderueshme.

Për rrjedhojë, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni nuk i konsideroi vlerat e përcaktuara në shkresat e lëshuara nga Drejtoria e Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave pranë Bashkisë Dibër si të ardhura reale dhe të ligjshme në analizën financiare të huadhënësit, por shpenzimet e jetesës së huadhënësit dhe familjes së tij janë reduktuar sipas shportës së produkteve ushqimore të përllogaritura nga INSTAT-i, referuar disa rrethanave arsyetuar më sipër.

45.6 Sa i takon faktit përse të ardhurat nga toka bujqësore në pronësi të vjehrrit të subjektit i ka përfituar vetëm huadhënësi P. H. dhe jo fëmijët e tjerë, subjekti vijon të deklarojë se tokat e vjehrrit të saj i ka shfrytëzuar vetëm P. H. dhe paraqiti disa argumente të cilat mbeten në nivel deklarativ, të cilat, për rrjedhojë, u konsideruan jo bindëse. Veç kësaj, edhe nëse do të merrnim të mirëqenë pretendimin e subjektit se toka e vjehrrit të saj është shfrytëzuar vetëm nga

⁵⁴Shihni shkresat nr. *** prot., datë 22.7.2021 dhe nr. *** prot., datë 30.7.2021, nga Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave, Bashkia Dibër, në dosjen e Komisionit.

huadhënësi P. H., mbeten të paqarta rrethanat si vijojnë: (i) a ka pasur mundësi ky shtetas të kultivojë dhe punojë tokën e tij dhe të babait të tij kur ka jetuar midis Shqipërisë dhe Greqisë; (ii) a ka pasur mundësi bashkëshortja e huadhënësit P. H., sikundër është pretenduar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, për të punuar tokat (e tij dhe të babait) në kushtet kur, nga shtatori i vitit 2003, ajo rezulton të ketë marrë pension invaliditeti; (iii) përse ky shtetas i ka dhënë hua vëllait të tij, bashkëshortit të subjektit, të gjitha kursimet e jetës së tij nga puna si emigrant në Greqi.

45.7 Gjatë parashtrimeve pretendohet se vëllai i bashkëshortit të subjektit, P. H., ashtu sikurse edhe vëllai tjetër P. H., kanë pasur edhe të ardhura të tjera të padokumentuara gjatë viteve 1992 - 2000 në shtetin grek nga puna në ndërtim, duke dhënë shpjegime të detajuara, duke paraqitur: deklaratë noteriale nr. ***, datë 11.6.2021, të deklaruesve P. dhe N. H., në të cilat konfirmohen deklaratimet e subjektit; dhe leje qëndrimi (pune) të huadhënësit P. H. në vitin 1998. Në lidhje të ardhurat e huadhënësit P. H. gjatë viteve 1992 - 2000, subjekti ka deklaruar se është në kushtet e pamundësisë objektive për t'i vërtetuar ato, sipas nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, ndërkohë që nuk ka paraqitur asnjë dokument shkresor që të vërtetojë qoftë dhe në mënyrë indirekte që ky shtetas ka jetuar dhe punuar në Greqi gjatë kësaj periudhe, me përjashtim të lejes së qëndrimit në shtetin grek për vitin 1998 dhe, për rrjedhojë, nuk ka vërtetuar pamundësinë për të vërtetuar të ardhura të tij gjatë kësaj periudhe.

46. Në përfundim, bazuar në të gjitha parashtrimet sa më sipër, subjekti kërkon që të ardhurat nga bujqësia dhe blegtoria duhet të konsiderohen si të ardhura të ligjshme në analizën financiare të huadhënësit dhe ka paraqitur një analizë financiare⁵⁵, sipas të cilës shtetasi P. H. ka pasur mundësi të krijojë shumën 60.000 euro, si dhe të krijojë një tepricë fondesh prej 3.673.340 lekësh për vete dhe familjen e tij.

47. Nga të gjitha pretendimet e mësipërme të subjektit në lidhje me aftësinë e huadhënësit P. H., për të krijuar shumën e huas prej 60.000 euro, si dhe për të krijuar pasuritë dhe për të mbuluar shpenzimet e tij dhe të familjes, Komisioni ka konsideruar disa nga pretendimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, sikurse trajtuar në paragrafët 45.1 dhe 45.2 të këtij vendimi. Pas rishikimit të kësaj analize, në konsideratë të këtyre pretendimeve, balanca negative e huadhënësit ka ndryshuar nga 3.243.707 lekë në 2.530.319 lekë.

47.1 Sa i takon analizës së kryer për pasurinë apartament banimi në Tiranë, subjekti pretendoi se Komisioni, pa të drejtë në këtë analizë, i ka konsideruar shpenzimet e jetesës sipas standardit të ILDKPKI-së dhe se këto shpenzime duhet të reduktohen për shkak se janë deklaruar rregullisht të ardhura nga toka bujqësore. Gjithashtu, subjekti pretendon se likuiditetet në *cash* me burim të ardhura nga toka bujqësore, pa të drejtë Komisioni nuk i ka përfshirë në analizën financiare. Subjekti argumenton se të ardhurat e përfituara në natyrë nga toka bujqësore i ka konvertuar në vlera monetare dhe për këtë shkak ka deklaruar likuiditete në *cash* me burim nga dhënia në përdorim e tokës bujqësore. Në analizë të këtij pretendimi, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, likuiditetet në *cash*, të deklaruara me burim të ardhura nga dhënia në përdorim e tokës bujqësore, nuk u konsideruan si e ardhur e ligjshme për shkak se nuk u vërtetua të jetë paguar tatimi mbi të ardhurën e deklaruar si një vlerë monetare. Sa i takon

⁵⁵Në analizën e paraqitur nga subjekti është pretenduar të përfshihen: të ardhura nga toka bujqësore e shtetasi P. H. në shumën 1.610.000 lekë; të ardhura nga toka bujqësore e shtetasi H. H. në shumën 1.449.000 lekë dhe të ardhura të padokumentuara në shtetin grek për vitet 1992 - 2000, në shumën 2.800.000 lekë.

shpenzimeve të jetesës, nisur nga disa fakte dhe rrethana (pronësia mbi tokën, pagesa e taksës mbi tokën, mbjellja dhe marrja e produkteve nga toka), si dhe fakti që në DPV subjekti ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore, Komisioni vlerësoi të reduktojë shpenzimet e jetesës së subjektit sipas shportës së produkteve ushqimore të përlllogaritura nga INSTAT-i, gjë që afekton analizën financiare të dërguar me rezultatet e hetimit administrativ.

48. Përveç argumenteve të paraqitura më sipër, subjekti sjell në vëmendje qëndrimin e Komisionit në disa vendimmarrje, ku, sipas saj, janë përlllogaritur të ardhurat nga toka bujqësore, si dhe shpenzimet e jetesës së familjeve bujqësore për shkak të ekonomisë bujqësore janë konsideruar më të ulëta, duke përmendur konkretisht vendimet: nr. ***, datë 4.2.2020; nr. ***, datë 28.1.2020; nr. ***, datë 26.2.2020; nr. ***, datë 22.4.2021; dhe nr. ***, datë 26.7.2019.

48.1 Pasi u shqyrtuan këto vendime, Komisioni konstatoi se:

- Në vendimin nr. ***, datë 4.2.2020, në pikën 3.39 është arsyetuar mbi ligjshmërinë e burimit të shumës prej 800.000 lekësh, dhënë si hua subjektit nga babai, me të ardhura të siguruara nga vetëpunësimi i tij në bujqësi, duke vlerësuar faktet si: pasja në pronësi e tokës bujqësore; pagesa e kontributeve si të vetëpunësuar në bujqësi; pagesa e taksës së tokës; si dhe rendimenti i tokës bujqësore dhe të ardhurat e realizueshme.

- Në vendimin nr. ***, datë 28.1.2020, në pikën 6.4 është arsyetuar mbi ligjshmërinë e shumës prej 800.000 lekësh përdorur nga babai i subjektit për blerjen e një apartamenti banimi, me të ardhura si të vetëpunësuar në bujqësi, duke vlerësuar faktet si: pasja në pronësi e tokës bujqësore; pagesa e kontributeve si të vetëpunësuar në bujqësi; është ushtruar aktivitet bujqësor dhe blegtoral; ka paraqitur dokumentacion se ka blerë dhe shitur bagëti, si dhe ka pasur vreshta të mbjella me rrush dhe aktivitet bletarie. Në këtë vendim është konsideruar fakti se familjet bujqësore shpenzimet e jetesës i kanë më të vogla se familjet e tjera që llogariten nga INSTAT-i.

- Në vendimin nr. ***, datë 26.2.2020, në pikën 24.8.10 është arsyetuar mbi ligjshmërinë e shumës prej 4.126.418 lekësh si kontribut i prindërve të subjektit me të ardhura nga shfrytëzimi i ullishtave, duke vlerësuar dokumentacionin e depozituar dhe të dhënat e INSTAT-it.

- Në vendimin nr. ***, datë 22.4.2021, është arsyetuar mbi ligjshmërinë e shumës prej 152.803 lekësh, përdorur si burim për pagesën e një kësti nga familja e subjektit në shumën 1.237.500 lekë.

- Në vendimin nr. ***, datë 26.7.2019, është arsyetuar mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës 5.000 euro, dhënë si hua subjektit nga babai me të ardhura të siguruara nga vetëpunësimi i tij në bujqësi, duke vlerësuar faktet si vijojnë: janë paguar detyrimet lidhur me sigurimet shoqërore; ka pasur tokë në pronësi; si dhe ka ushtruar aktivitet bujqësor. Është konsideruar fakti që shpenzimet e jetesës për familjet bujqësore janë më të vogla.

48.2 Bazuar në arsyetimet e vendimeve të referuara më sipër, rezulton se janë analizuar rast pas rasti pretendimet e subjekteve në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore, në konsideratë të disa fakteve, si: pasja në pronësi ose në përdorim e tokës, sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”; pagimi i takës mbi tokën; vërtetimi i tjetërsimit apo dhënies së tokës në përdorim (me kontratë shitjeje, qiramarrjeje, huapërdorjeje etj.); vërtetimi i ushtrimit të aktivitetit bujqësor nga anëtarët e familjes bujqësore apo qenia e tyre banorë në rrethin ku ndodhet toka

dhe ushtrojnë aktivitetin; vërtetimi i të ardhurave nga shitja me dokumente shkresore, etj. Por në përfundim, Komisioni çmon se vlerësimi i provave, është bërë në çdo rast (dhe duhet të bëhet) në raport me kushtet specifike të secilit prej subjekteve.

48.3 Konkretisht, në ndryshim nga rasti konkret që i përket subjektit Irena Hoxha, në rastet e tjera të referuara prej saj konstatohet se:

i) Shuma e huas ose ndihmës financiare e marrë nga këto subjekte ka qenë më e ulët, krahasimisht me huan 60.000 euro, marrë nga subjekti Irena Hoxha. Pra, në këto raste, shumat në fjalë janë marrë në konsideratë duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, pasi duke qenë shuma modeste, mundësia për t'i dhënë hua ose ndihmë është më reale. Ndërsa në rastin konkret, bëhet fjalë për një shumë të konsiderueshme që e bën më të vështirë dhe më të largët qasjen me situatën faktike.

ii) Në të gjitha rastet e referuara që Komisioni i ka marrë në konsideratë të ardhurat nga bujqësia, thelbësore nuk ka qenë vlera e të ardhurave nga bujqësia të pranuar nga Komisioni, por vlera e këtyre të ardhurave në proporcion me huan ose ndihmën financiare të dhënë ndaj subjektit. Në rastin konkret, huadhënësi ka përdorur pothuaj të gjitha të ardhurat e fituara nga emigracioni në Greqi për një periudhë 10-vjeçare, duke mbuluar të gjitha shpenzimet e tjera të tij dhe familjes me të ardhura të përfituara nga toka bujqësore prej 1.000 m² në pronësi të tij, si dhe pjesën më të madhe, me të ardhura nga toka bujqësore prej 7.975 m², në pronësi të babait të tij (vjeherri i subjektit), pavarësisht se në familjen e origjinës janë katër vëllezër.

iii) Në të gjitha rastet e referuara, shumat e huave të dhëna në raport me shumën e blerjes së pasurisë, ka qenë në vlera disa herë më e ulëta, krahasimisht me vlerën e pasurisë. Ndërsa në rastin e subjektit Irena Hoxha, huaja ka qenë në vlerën 60.000 euro ose 2/3 e vlerës së apartamentit të blerë nga subjekti.

48.4 Përveç sa është parashtruar hollësisht në arsyetimin e këtij vendimi gjatë analizës që i është bërë huas dhe të ardhurave të ligjshme të huadhënësit, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes së subjektit Irena Hoxha, Komisioni krijoi bindjen se provat e administruara në raport me rrethanat specifike të këtij subjekti nuk vërtetuan dhe as i krijuan bindjen Komisionit që personi tjetër i lidhur P. H. ka pasur të ardhura të ligjshme për dhënien e huas prej 60.000 euro subjektit në vitin 2010, çka ka afektuar direkt analizën financiare të subjektit të rivlerësimit. Pas rishikimit të kësaj analize, në konsideratë të disa prej pretendimeve të subjektit, balanca negative nga 7.069.519 lekë u bë 6.196.360 lekë.

49. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “*Autoveturë 4+1 vende, me vlerë 500.000 lekë. Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 17.3.2009. Burimi: paga dhe nga shitja e automjetit, sipas kontratës nr. ***, datë 15.2.2008. Vlera: 500.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %*”.

Hetimi i Komisionit

50. Në lidhje me origjinën, mënyrën e krijimit dhe deklaratimet e subjektit, nga aktet në dosje⁵⁶ u vërtetua se: (i) DPSHTRR-ja konfirmoi të regjistruar në emër të shtetasit N. H. H. automjetin me targa *** (ish targa ***); (ii) me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. ***, datë 10.3.2008, shtetasi H. H. (vëllai i bashkëshortit të subjektit) ka blerë nga shtetasi T. T.

⁵⁶Shihni aktet në aneksin 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së dhe aktet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 8.5.2020, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

automjetin me targa ***, në vlerën 500.000 lekë⁵⁷; (iii) me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 17.3.2009, shtetasi N. H. (bashkëshorti i subjektit) ka blerë nga vëllai i tij, H. H., automjetin me çmimin 500.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Në DPV-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar blerjen e këtij automjeti, por pa deklaruar burimin e krijimit. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, në lidhje me këtë konstatim, në parashtrimet e saj subjekti ka deklaruar se mosdeklarimi i burimit ka qenë thjesht një lapsus nga ana e saj. Ndërkaq, e pyetur gjatë procesit mbi pagimin e detyrimeve doganore, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti paraqiti: (i) deklaratë doganore lëshuar nga Pika Kufitare B., e datës 10.3.2008; dhe (ii) mandatpagesë nr. ***, datë 10.3.2008. Sipas këtyre dokumenteve vlera e detyrimit doganor për këtë automjet është paguar nga shtetasi T. T., por pa mundur të dallohej qartësisht vlera e zhdoganimit dhe vlera e automjetit. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, lidhur me këtë konstatim, në parashtrimet e saj subjekti ka informuar se edhe vetë deklarata doganore e pa fotokopjuar nuk arrihej që të lexohej.

51. Referuar sistemit të AMF-së, nga të dhënat e policëmbajtësit, sipas policës me kod ***, rezulton se që në momentin e blerjes së automjetit nga vëllai i bashkëshortit H. H., datë 10.3.2008, përdorues është edhe bashkëshorti i saj N. H.. Subjekti, pasi i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me këtë fakt, në parashtrimet e veta ka informuar se kjo ka qenë për shkak se në periudhën kohore mars 2008 – mars 2009, ata nuk kishin automjet në pronësi, bashkëshorti i saj dispononte automjet për shkak të punës⁵⁸ dhe se kunati H. H. ka vendosur emrin e bashkëshortit të saj tek siguracioni i automjetit në pronësi të tij, që ai ta përdorte automjetin në mënyrë të pavarur në rast se do i duhej për prindërit, ndërkohë që po sipas subjektit, ajo nuk ka pasur fare dijëni për këtë fakt. Sipas subjektit, gjendja shëndetësore e prindërve të tij ka qenë e mirë, prandaj bashkëshorti nuk e ka përdorur në këtë kohë këtë automjet.

Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me përdorimin e këtij automjeti nga bashkëshorti i subjektit që në vitin 2008, Komisioni i vlerësoi bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti, se përdorimi i automjetit që në vitin 2008 ishte lejuar nga vëllai i bashkëshortit me qëllim përdorimin e automjetit në funksion të dy prindërve të tyre të moshuar, për më tepër që bëhet fjalë për një marrëdhënie mes dy njerëzve shumë të afërt. Deklarimi i këtij automjeti në DPV 2009, dëshmon se subjekti nuk ka pasur si qëllim fshehjen e tij, ndërkohë që edhe nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për blerjen e tij në vitin 2008.

52. Në lidhje me burimin e krijimit të automjetit, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: (i) pagat; dhe (ii) shitjen e automjetit sipas kontratës nr. ***, datë 15.2.2008. Sa i takon të ardhurave nga pagat⁵⁹ deri në datën 17.3.2009, bazuar në dokumentet e administruara, janë në vlerën 505.622 lekë. Sa i takon burimit të të ardhurave nga shitja e automjetit sipas kontratës nr. ***, datë 15.2.2008⁶⁰, është konstatuar se në DPV-në e vitit 2008 subjekti e ka deklaruar shitjen e këtij automjeti duke cituar kontratën e shitjes, por nuk e ka deklaruar shumën prej 250.000 lekësh, si gjendje *cash* në fund të vitit 2008. Ndërsa në deklaratën *Vetting*, të ardhurat

⁵⁷Me deklaratën doganore të datës 10.3.2008 dhe mandatpagesën nr. ***, datë 10.3.2008, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, vërtetohet zhdoganimi nga shtetasi T. T..

⁵⁸Provuar me shkresat nr. *** prot., datë 9.7.2007, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe nr. *** prot., datë 27.7.2007 me lëndë "Autorizim", e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Rugore Dibër, të cilat informojnë se shtetasi N. H., si specialist i Sektorit të Mirëmbajtjes Rruga Peshkopi autorizohet të qarkullojë me automjetin tip "Mitsubishi", me targa ***.

⁵⁹Paga e subjektit, bashkëshortit dhe pensionet e prindërve të tij.

⁶⁰Shihni aktin në aneksin 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

nga shitja e automjetit sipas kontratës nr. ***, datë 15.2.2008, i ka deklaruar si burim edhe për blerjen e automjetit objekt shqyrtimi në mars të vitit 2009 edhe si shtesë *cash* në fund të vitit 2009 të përdorur për blerjen e apartamentit në vitin 2010.

53. Subjekti, për shkak të kësaj paqartësie, u pyet të sqarojë se për cilën pasuri kanë shërbyer të ardhurat në vlerën 250.000 lekë, përfituar nga shitja e automjetit në vitin 2008. Në përgjigjet e datës 13.8.2021, subjekti ka sqaruar se: *“Të ardhurat nga shitja e automjetit në vitin 2008 janë përdorur për shtimin e gjendjes cash në vitin 2008. Kjo gjendje është përdorur për blerjen e automjetit në vitin 2009, por deri në fund të vitit 2009, shuma e përdorur u zëvendësua me kursimet deri në fund të vitit. Në vitin 2010 kursimet e krijuara deri në fund të vitit 2009 janë përdorur për blerjen e apartamentit. Kjo është pasur parasysht në deklaratën Vetting duke qenë se DPV-ja është me shtrirje kohore njëvjeçare”*.

54. Pavarësisht pretendimit se të ardhurat nga shitja e automjetit në vitin 2008 janë përdorur për shtimin e gjendjes *cash* të po këtij viti, shuma prej 250.000 lekësh, përfituar në datën 15.2.2008, nuk është deklaruar si gjendje apo shtesë *cash* në DPV-në e vitit 2008, deklarim i cili do të përbente provën që kjo shumë është përdorur për shtimin e gjendjes *cash*, sikurse kërkohet nga ligji nr. 9049/2003 dhe nga formulari i deklaratimit në ILDKPKI. Veç kësaj, kjo shumë është deklaruar si burim edhe për blerjen e apartamentit në vitin 2010. Për këto arsye, shuma e përfituar nga shitja e automjetit në vitin 2008 prej 250.000 lekësh, nuk është konsideruar në analizën financiare si burim për blerjen e automjetit objekt shqyrtimi në vitin 2009, pasqyruar në tabelën vijuese.

Përshkrimi	17.3.2009
Pasuri	502 202
Automjet tip “Land Rover” ***	500 000
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	2 202
Total likuiditete	2 353 824
Të Ardhura	505 622
Të ardhura nga pagat subjekti	260 616
Të ardhura nga pagat bashkëshortja	202 328
Të ardhura nga pagat vjehri	33 825
Të ardhura nga pagat vjehrra	8 853
Shpenzime	199 301
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së për 7 persona ⁶¹	177 780
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	21 521
Mundësia për kursime	-195 881

55. Në përfundim të hetimit administrativ, duket se subjekti nuk ka justifikuar tërësisht blerjen e automjetit në vitin 2009 me të ardhura të ligjshme për shkak të një balance negative prej 195.881 lekësh. Në DPV-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar blerjen e këtij automjeti, por pa deklaruar burimin e krijimit. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

Në parashtrimet e veta, subjekti thekson edhe një herë se si burim për blerjen e automjetit kanë shërbyer pagat dhe të ardhurat nga shitja e automjetit në shumën 250.000 lekë në vitin 2008, sikurse e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2009 dhe gjatë gjithë hetimit administrativ. Sa i takon

⁶¹Për vjehrrin dhe vjehrrën shpenzimet e jetesës janë barazuar me pensionet.

konstatimit të Komisionit se shuma prej 250.000 lekësh nuk është deklaruar si gjendje *cash* në DPV-në e vitit 2008, subjekti ka parashtruar se kjo shume është deklaruar në DPV për këtë vit edhe në seksionin “Ndryshimi i interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” si shtim i likuiditetit, megjithëse pa përdorur shënimin *cash*, po ashtu dhe tek seksioni “Të ardhurave” për shkak të përfitimit të tyre nga shitja. Ne këtë mënyrë, subjekti e konsideron lapsus mosshënimin e fjalës “*cash*”.

56. Sa i takon këtij pretendimi, ne procesin e vlerësimit përfundimtar, Komisioni çmon se është bindës, pasi shuma 250.000 lekë, pavarësisht se nuk është shprehur në mënyrë specifike si *cash*, është deklaruar në rubrikën e duhur dhe, për këtë arsye kjo shumë, në përfundim, është konsideruar si burim për blerjen e automjetit në datën 17.3.2009. Sipas analizës financiare të rishikuar, ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti, për shkak se rezultati financiar ka ndryshuar nga vlera -195.881 lekë në vlerën 157.054 lekë.

57. Komisioni kreu hetime edhe në lidhje me automjetin e shitur në datën 15.2.2008, i cili ishte blerë nga bashkëshorti i subjektit, z. N. H., me kontratën nr. ***, datë 6.1.2003, nga shtetasi I. T. (automjeti ka pasur targa të huaja *** me nr. shasie ***), në vlerën 250.000 lekë. Ky automjet nuk është deklaruar nga subjekti në deklarimin para fillimit të detyrës për vitin 2003, por është deklaruar në deklarimin për vitin 2004 si automjet tip “Mercedes-Benz 250”, me targa ***, në vlerën 250.000 dhe burim i kësaj të ardhure është deklaruar shuma e përfituar nga vendimi nr. *** i Gjykatës së Apelit Tiranë⁶². Në parashtrime subjekti ka sqaruar se mosdeklarimi i automjetit në DPV-në e vitit 2003, ka qenë një harresë e saj, e cila është korrigjuar në deklaratën pasardhëse të vitit 2004.

58. Ne deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Tokë bujqësore me sip. 5409 m² në të cilën përfshihet 200 m² truall, ndërtesë 80 m², në z. k. ***, e ndodhur në F. Dibër, e regjistruar në bashkëpronësi 1/3, sipas dëshmisë së trashëgimisë nr. *** vendimi, datë 10.7.2013, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër. Pjesa takuese: 33%*”. Nuk deklarohet vlera.

59. Gjatë hetimit administrativ: (i) ASHK-ja Dibër⁶³ ka informuar se shtetasi M. M. K. (babai i subjektit) ka të regjistruar sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, si përfaqësues i familjes bujqësore, pasuritë në F., Dibër: nr. *** arë+truall me sip. 416 m², nr. *** arë me sip. 1000 m², nr. *** arë me sip. 812 m², nr. *** arë me sip. 1100 m², nr. *** arë me sip. 1000 m², në total 4328 m² (më pak nga sa deklarohet nga subjekti); (ii) FSHU-ja⁶⁴ nuk ka konfirmuar kontratë furnizimi me energji elektrike në emër të subjektit, prindërve të saj apo bashkëshortit në Dibër.

60. Në lidhje me origjinën e kësaj pasurie nga aktet⁶⁵ rezultoi se:

- sipas AMTP-së nr. ***, familjes së shtetasit M. M. K. i jepet në pronësi tokë gjithsej me sip. 5429 m², në fshatin F.;

- me vendimin nr. ***, datë 10.7.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit M. K. duke njohur si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të tij bashkëshorten M. K. dhe fëmijët Irena Hoxha (K.) dhe V. K., të

⁶²Shihni vendimin nr. ***, datë 22.10.2002, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vërtetimin nr. *** prot., datë 2.11.2016, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, bashkëngjitur përgjigje të pyetësorit nr. 2.

⁶³Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 1.7.2020, nga ASHK-ja Dibër në dosjen e Komisionit.

⁶⁴Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.5.2020, nga FSHU-ja në dosjen e Komisionit.

⁶⁵Shihni aktet në aneksin 4/1, 46 dhe 47 në dosjen e ILDKPKI-së.

cilët trashëgojnë në pjesë të barabartë secili nga 1/3 e pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit dhe në DPV-në e vitit 2014 ka kryer deklaramë për këtë pasuri;

- sipas vërtetimit të datës 15.10.2016 të ZVRPP-së Dibër rezulton se shtetasja Irena Hoxha ka të regjistruar në bashkëpronësi 1/3 pasurinë e regjistruar sipas dëshmisë së trashëgimisë me nr. ***, datë 10.7.2013, tokë bujqësore në sasinë me sip. 5409 m², në të cilën përfshihen edhe trualli me sip. 200 m² dhe ndërtesë me sip. 80 m², në z. k. *** (F.);

- në përgjigjet e pyetësorit nr. 1 dhe 2, subjekti ka informuar se ndërtesa me sip. 80 m² është ndërtuar në vitet 1979 – 1980 nga prindërit e saj, pasuri e cila nuk është shfrytëzuar prej saj që nga viti 1996 kur është martuar. Aktualisht, kjo pasuri, banesa dhe toka bujqësore zotërohet dhe gëzohet nga vëllai i saj, z. V. K., i cili ka kryer çdo investim – deklaramë të cilat i vërteton me disa dokumente shkresore⁶⁶.

61. Në përfundim të hetimit administrativ nuk kanë rezultuar problematika dhe dyshime në lidhje me këtë pasuri, e cila është deklaruar nga subjekti si bashkëpronare *de jure* për shkak të trashëgimisë ligjore. Nuk janë evidentuar të dhëna për investime nga subjekti.

62. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Vlerë në lekë gjendje në momentin e deklarimit (cash). Vlerë e kursyer nga të ardhurat e pagave, pensione dhe nga toka që është në pronësi të babait të bashkëshortit. Vlera: 730.000 lekë. Pjesa takuese: 50%*”.

63. Për të verifikuar këtë deklaramë të subjektit në lidhje me gjendjen *cash* prej 730.000 lekësh, Komisioni iu referua deklaramëve të gjendjes *cash* në DPV, si dhe deklaramëve në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ku subjekti ka sqaruar se çfarë përfaqësojnë deklaramët vjetore në lidhje me gjendjen *cash*. Në përgjigje, subjekti ka saktësuar se sa janë shtesat e kursyera gjatë një viti, sa janë pakësimet në rastin e përdorimit të gjendjes *cash* të akumuluar dhe sa është gjendja *cash* në fund të çdo viti kalendarik, deklaramë të cilat janë në të njëjtën linjë me deklaramët periodike vjetore dhe me deklaratën *Vetting*, në mënyrën e pasqyruar si vijon:

i) DPV-ja e vitit 2006: gjendje 600.000 lekë, të ardhura *cash* nga pagat, vlera është progresive dhe e akumuluar;

ii) DPV-ja e vitit 2007: gjendje 800.000 lekë, të ardhura *cash* nga pagat, vlera e akumuluar është 1.400.000 lekë;

iii) DPV-ja e vitit 2008: gjendje 1.200.000, nga të cilat 950.000 lekë të ardhura *cash* nga pagat dhe 250.000 lekë të ardhura *cash* nga shitja e automjetit me targa DI 2957 A. Vlera e akumuluar është 2.600.000 lekë;

iv) DPV-ja e vitit 2009: gjendje 700.000 lekë të ardhura *cash* nga pagat, vlera e akumuluar është 3.300.000 lekë;

v) DPV-ja e vitit 2010: gjendje 1.200.000 lekë krijuar nga diferenca e të ardhurave nga pagat dhe toka në përdorim, vlera e akumuluar është 4.500.000 lekë. Vlera e akumuluar prej 4.500.000 lekësh është përdorur për blerjen e shtëpisë në vlerën 3.740.000 lekë në Tiranë dhe 760.000 lekë është përdorur për nevoja familjare, si dhe për disa riparime të vogla të banesës. Gjendja më 31.12.2010 është 0 (zero) lekë;

⁶⁶Shihni deklaratën noteriale nr. ***, datë 6.7.2021, lëshuar nga shtetasi V. K., foto të banesës njëkatëshe; vërtetim nr. ***, datë 24.12.2019, lëshuar nga Bashkia Dibër sipas së cilës shtetasi V. K. ka likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore, në dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3.

vi) DPV-ja e vitit 2011: gjendje 370.000 lekë të ardhura *cash* nga pagat, pensionet dhe toka e lënë në përdorim, të paregjistruara ne regjistrat publikë. Vlera e akumuluar: 370.000 lekë.

vii) DPV-ja e vitit 2012: gjendje 450.000 lekë të ardhura *cash* nga pagat, pensionet, qiraja e apartamentit dhe toka e lënë në përdorim, të paregjistruara në regjistrat publikë. Vlera e akumuluar: 820.000 lekë;

viii) DPV-ja e vitit 2013: gjendje 400.000 lekë, krijuar nga diferenca e të ardhurave *cash* nga pagat, pensionet, dëmshpërblimi sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të ardhurat nga toka e lënë në përdorim për vitin 2013. Vlera e akumuluar: 1.220.000 lekë;

ix) DVP-ja e vitit 2014, vlera e kursyer prej 840.000 lekësh nga diferencat e të ardhurave nga pagat, pensionet dhe të ardhurat nga toka e lënë në përdorim, nuk është gjendje pasi është përdorur për shlyerjen e këstit të huas, sikurse është bërë shënimi përkatës në DPV-në e vitit 2014 “vlerë që është përdorur për shlyerjen e këstit të huas prej 6.000 euro”. Vlera e akumuluar: 1.220.000 lekë;

x) DPV-ja e vitit 2015, vlera e kursyer prej 120.000 lekësh nga diferencat e të ardhurave *cash* nga pagat, pensionet dhe të ardhurat nga toka e lënë në përdorim për vitin 2015. Shuma 10.000 lekë, dhënë ndihmë financiare, familje në nevojë, vlera e akumuluar: 1.330.000 lekë.

64. Sqarimet e dhëna nga subjekti në lidhje me shumatat e deklaruara *cash* qëndrojnë, pasi deklaratimet e shtesave/pakësimeve të gjendjeve *cash*, ndër vite (me përjashtim të vitit 2008), përputhen me përlllogaritjet e gjendjeve në fund të çdo viti, të kryera nga Komisioni, sipas të cilave gjendja *cash* e deklaruar në deklaratën *Vetting*, është e saktë. Për rrjedhojë, deklarimi në lidhje me gjendjen *cash* 730.000 lekë në deklaratën *Vetting* është i saktë.

65. Në rubrikën “detyrime financiare”, subjekti ka deklaruar: “*Kontratë huaje nr. ***, datë 3.11.2010. Vlera e huamarrjes nga bashkëshorti 60.000 euro. Afati 12 vjet. Shlyer në progresiv sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 20.10.2016, vlera 40.000 euro. Shuma e detyrimit të mbetur pa shlyer 20.000 euro*”.

66. Gjatë hetimit administrativ, në lidhje me këtë detyrim financiar, rezultoi se:

- Në DPV-në e vitit 2010, në rubrikën “detyrimet financiare” subjekti ka deklaruar kontratën e huas me të njëjtat terma. Sipas kontratës, kthimi i huas do të bëhet me këste prej 5.000 euro në fund të çdo viti, deri në likuidimin e plotë të shumës së marrë hua.

- Në DPV-të e viteve 2011 – 2016, subjekti ka deklaruar këstet e shlyera (jo ne vlerën prej 5.000 euro), si dhe detyrimet e mbetura financiare.

- Shlyerja e detyrimit në shumën totale prej 40.000 euro konfirmohet edhe me deklaratën noteriale nr. ***, datë 20.10.2016, të huadhënësit P. H., i cili specifikon shlyerjet: 6.000 euro më 1.11.2011; 6.000 euro më 1.11.2012; 10.000 euro më 1.11.2013; 6.000 euro më 25.12.2014; 4.000 euro më 23.12.2015; dhe 8.000 euro më 20.10.2016. Pra, është likuiduar shuma 40.0000 euro, duke pasur pa likuiduar edhe shumën prej 20.000 euro në përmbajtje të detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e huas.

67. Në analizën financiare, pasqyruar në tabelën më poshtë, rezulton se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për shlyerjen e huas në vitet 2011 – 2016 dhe se pamundësia totale për shlyerjen e shumës prej 40.000 euro është -2.590.457 lekë.

	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Pasuri	377 586	503 410	392 889	-11 255	122 212	-646 966
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	<i>377 586</i>	<i>503 410</i>	<i>392 889</i>	<i>-11 255</i>	<i>122 212</i>	<i>-646 966</i>
Total likuiditete	381 701	885 112	1 278 000	1 266 745	1 388 956	741 991
Të ardhura	2 122 309	2 092 770	2 856 667	1 860 182	1 615 575	1 772 721
Të ardhura nga pagat SR	1 223 803	1 166 752	1 172 062	1 363 159	1 351 036	1 344 718
Të ardhura nga pagat BSH	676 906	439 730	0	239 760	0	214 008
Të ardhura nga pagat	156 642	161 874	167 292	180 668	186 772	150 122
Të ardhura nga pagat	64 958	69 414	72 213	76 595	77 767	63 873
Përfiturar b/shorti nga			1 445 100			
Të ardhura nga qira ap.		255 000				
Shpenzime	2 061 882	2 044 712	2 552 196	2 409 759	2 142 371	2 961 885
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	904 700	929 028	944 625	1 357 253	1 385 919	1 389 455
Shlyer huaja	829 800	838 320	1 402 100	840 660	550 000	1 096 000
Shpenzime udhëtimi sipas	119 882	77 364	41 121	41 846	46 452	62 653
Shpenzime shkollimi djali						263 777
Shpenzime të tjera të	7 500		4 350			
Burimi i paligjshëm i krijimit të gjendjes <i>cash</i>	200 000	200 000	160 000	170 000	160 000	150 000
Mundësia për kursime	-317 159	-455 353	-88 418	-538 321	-649 008	-542 198

68. Në këtë analizë, e cila i është bërë me dije subjektit të rivlerësimit me njoftimin e rezultateve të hetimit, shuma prej 1.040.000 lekësh që përbën shumatoren *cash* të krijuar gjatë viteve 2011 – 2016, me burim të ardhura nga toka e lënë në përdorim, të paregjistruara në regjistrat publikë, nuk ishte përfshirë si e ardhur e ligjshme (pasqyruar në analizë në zërin “burim i paligjshëm i krijimit të gjendjes *cash*”).

Pas marrjes në konsideratë të prapësimeve të subjektit, nga analiza financiare në përfundim të hetimit administrativ, balancat e mësipërme janë kthyer nga negative në pozitive⁶⁷, për shkak se janë reduktuar shpenzimet e jetesës sipas shportës së produkteve ushqimore, çështje e trajtuar hollësisht përgjatë këtij vendimi.

69. Në deklaratën *Vetting* janë deklaruar të ardhura nga subjekti dhe babai i bashkëshortit si vijon: (i) subjekti ka deklaruar të ardhura në natyrë nga toka ndër vite, 1992 – 2016, shumën 2.680.000 lekë, e detajuar në deklaratën e pasurisë së personit të lidhur, deklaruar nga babai i bashkëshortit; (ii) babai i bashkëshortit ka deklaruar të ardhura në natyrë nga toka ndër vite 1992 – 2006 shumën 1.100.000 lekë; dhe nga viti 1992 deri në vitin 2016 ka deklaruar shumën 2.680.000 lekë. Por, nuk ka paraqitur dokumentacion për të vërtetuar këto të ardhura.

70. Nga shqyrtimi i DPV-ve për vitet 2003 – 2016, subjekti ka deklaruar të ardhura nga toka në total prej 1.710.000 lekësh, në këtë mënyrë:

- në DPFD-në e vitit 2003 nuk ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore;
- në DPV-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar të ardhura nga toka, e lënë në përdorim, në shumën 10.000 lekë, me sqarimin “qira vjetore verbale”;
- në DPV-të e viteve 2005 – 2009, subjekti ka deklaruar të ardhura nga toka e lënë në përdorim, pa dhënë detaje, pra, nuk ka ndryshim të deklarimit të vitit 2004, sipas të cilit toka është dhënë me qira;

⁶⁷Shihni analizën përfundimtare financiare.

- në DPV-të e viteve 2010 – 2016, subjekti ka deklaruar të ardhura nga toka e lënë në përdorim, ndërsa në deklarinimin e gjendjeve *cash* të këtyre viteve ka deklaruar si burim të ardhura nga pagat dhe nga lënia e tokës në përdorim. Ndërsa në DPV-në e vitit 2011 e në vijim, ka bërë edhe sqarimin “te paregjistruara në regjistrat publikë”, duke nënkuptuar që marrëveshjet për dhënien e tokës kanë qenë verbale. Deklarimet e subjektit janë në të njëjtën linjë edhe me deklarinimin e të ardhurave nga dhënia me qira e apartamentit në Peshkopi në vitin 2012, ku ka shkruar të njëjtin sqarim “e paregjistruar në regjistrat publikë”. Siç vërehet, duket se subjekti ka përfituar të ardhura nga dhënia e tokës në përdorim (me ose pa qira), të cilat i ka deklaruar si një nga burimet e shtesave të likuiditeteve në deklarinimet vjetore. Duke qenë se për këto të ardhura nuk janë paguar detyrimet tatimore, nuk janë marrë në konsideratë si të ardhura e ligjshme në analizën financiare të njoftuar me rezultatet e hetimit administrativ.

71. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka ndryshuar deklarinimet në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore, duke deklaruar se janë të ardhura në natyrë. Subjekti, e pyetur gjatë procesit të rivlerësimit nëse të ardhurat nga toka të deklaruara janë në natyrë apo nga lënia në përdorim e tokës (me ose pa qira), në përgjigje të pyetësorit nr. 3 nuk është përgjigjur në mënyrë direkte, por ka deklaruar edhe një herë vlerat numerike të të ardhurave nga toka, të njëjta me ato të DPV-ve të viteve përkatëse, duke i emëruar “të ardhura në natyrë nga toka”. Ndërkohë, nuk jep asnjë sqarim mbi “të ardhurat nga qiraja vjetore verbale”.

72. Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore konstatohen mospërputhje në deklarinimet ndër vite, ku janë deklaruar të ardhura nga toka e lënë në përdorim në mënyrë verbale (me ose pa qira) me deklarinimet në deklaratën *Vetting* ku deklarohen të ardhura nga toka bujqësore në natyrë, qëndrim i cili vijon të jetë mbajtur edhe gjatë procesit të rivlerësimit. Subjektit i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

73. Në lidhje me këtë konstatim, në parashtrime, subjekti ka sqaruar se:

Së pari, familja e saj ka përfituar nga toka bujqësore vetëm produkte në natyrë dhe asnjëherë të ardhura në vlerë monetare. Sipas saj ata kanë kryer një përlllogaritje të përafërt të këtyre produkteve duke deklaruar vlerën e tyre në DPV, si të ardhura në natyrë. Mosblerja e këtyre produkteve u ka dhënë mundësi të krijonin kursime nga të ardhurat e tjera, kryesisht pagat.

Së dyti, toka e përfituar me AMTP në emër të vjehrrit është përdorur vetëm nga familja e subjektit dhe vëllait P. H., i cili ka përdorur edhe tokën e përfituar nga vjehrrit dhe tokën e përfituar prej tij. Togfjalëshi “lënë në përdorim” ka pasur kuptimin lënë në përdorim vëllait të bashkëshortit P. H., duke përfituar produktet në natyrë. Ndërkohë, ka deklaruar se familja e saj dhe e kunatit P. H., kanë realizuar edhe të ardhura nga shitja e produkteve bujqësore dhe blegtorale, por nuk e ka vërtetuar këtë deklarinim me ndonjë provë shkresore.

Së treti, togfjalëshi “qira vjetore verbale” e përdorur në DPV-në e vitit 2004 është perceptuar/shkruar gabim prej subjektit, dhe se, në këtë vit vlera e produkteve të përfituara prej 10.000 lekësh, nuk ka se si të mendohet si qira vjetore.

Së katërti, subjekti ka sqaruar se shënimin “e pa regjistruar në regjistrat publikë” e ka shënuar për shkak se ata nuk kanë disponuar certifikatë pronësie për tokën e përfituar nga ligji nr. 7501, por dhe për të treguar se nuk ka asnjë dokument zyrtarë që të vërtetojë vlerën e produkteve bujqësore.

74. Siç vërehet, subjekti pretendon se toka bujqësore nuk është dhëne me qira, por i është lënë në përdorim vëllait të bashkëshortit P. H. dhe se të ardhurat nga bujqësia kanë qenë në natyrë, të cilat pasi i ka konvertuar në vlerë monetare, i ka deklaruar edhe si burim të likuiditeteve *cash*, pretendim i cili nuk u vlerësua i bazuar, përderisa subjekti ka pretenduar vetëm produkte në natyrë nga bujqësia. Gjithsesi, në procesin e vlerësimit përfundimtar, Komisioni reduktoi shpenzimet e jetesës së subjektit gjatë periudhës së rivlerësimit duke marrë të mirëqenë faktin e përdorimit të produkteve në natyrë nga toka bujqësore në pronësi të vjehrrit të saj, por nuk i njohu të ardhurat nga toka bujqësore si burim për krijimin e likuiditeteve *cash*.

75. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. N. H., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar se nuk ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e tij. Në rubrikën “të dhëna konfidenciale” të deklaratës së tij është deklaruar: “*Kreditor (huadhënës) me shoqërinë ‘V.’ në vlerën 1.102.707.48 lekë, sipas shkresës nr. *** datë 18.1.2017, lëshuar nga administratori i shoqërisë ‘V.’. Kjo vlerë është e vëllait tim P. H., të ardhura nga emigracioni, por depozituar në emrin tim pasi vazhonte të ishte në emigracion, dhënë me deklaratë me shkrim dore nga ana e tij, kontratë nr. ***, datë 24.10.1996*”.

76. Gjatë hetimit administrativ, nga Komisioni u administruan: (i) shkresë e Ministrisë së Financave⁶⁸, e cila ka informuar se shtetasi N. H. është kreditor në shoqërinë “V. H.” me kontratën nr. ***, datë 24.10.1996, i cili ka depozituar vlerat 390.000 dhrahmi dhe 1.150.000 lekë; (ii) deklaratë dore e shtetasit P. H., i cili deklaroi se më 11.10.1996, i lë vëllait të tij, shtetasit N. H., vlerat 1.150.000 lekë dhe 390.000 dhrahmi, që t’i depozitojë te shoqëria “V. H.” dhe t’i tërheqë pas 6 muajsh, së bashku me interesat (deklarata lëshohet për shkak se ky shtetas ndodhet në Greqi dhe e ka të pamundur që t’i ndjekë afatet personalisht). Në këto dokumente nuk është provuar se shuma e investuar i takon vëllait të bashkëshortit të subjektit P. H., por duke qenë se bëhet fjalë për një shumë të krijuar përpara fillimit të detyrës nga subjekti, e cila nuk është përdorur si burim për krijimin e ndonjë pasurie nga subjekti, Komisioni nuk çmoi të kryejë hetime të mëtejshme.

77. Babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. H. H., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar se ka pasuri veçmas të regjistruara në emrin e tij. Konkretisht, ka deklaruar: “*Tokë bujqësore me sip. 8075 m², në të cilën përfshihet 100 m² truall, ku është ndërtuar shtëpi në vitin 1953 (shtëpia e paregjistruar në regjistrat publikë). Akti i marrjes së tokës në pronësi nr. regj. ***, z. k. *** K., Dibër. Pjesa takuese: 100%*” (trajtuar më sipër).

78. Nëna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, znj. N. H., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar se nuk ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj.

79. Djali i subjektit të rivlerësimit, E. H., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar se nuk ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e tij.

Konstatime të tjera

80. Gjatë hetimit administrativ, nga të dhënat e administruara nga FSHU-ja, rezultoi se:

⁶⁸Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.1.2017, nga Ministria e Financave në aneksin 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

i) Me gjeneralitetet Irena Hoxha ka dy kontrata të furnizimit me energji elektrike, nr. *** dhe nr. ***, në instancën Tiranë. Me gjeneralitetet A. H. rezultojnë 4 abonentë, nga të cilat 3 në Tiranë dhe 1 në Berat. E pyetur gjatë procesit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 subjekti ka informuar se ajo së bashku me djalin e saj A. N. H. nuk disponojnë kontrata furnizimi me energji elektrike, por vetëm bashkëshorti i saj si kryefamiljar disponon dy kontrata me OSHEE-në, që i përkasin banesës në qytetin e Peshkopisë dhe asaj ku banojnë aktualisht në Tiranë. Për të vërtetuar pretendimet, subjekti ka paraqitur: (a) shkresën nr. *** prot., datë 6.0.2021, nga FSHU-ja; (b) shkresat nr. *** prot., datë 6.7.2021, nga FSHU-ja, sipas të cilave subjekti Irena M. Hoxha me ID ***, dhe djali i saj A. N. H. me ID *** nuk rezultojnë të jenë abonentë me kontrata të furnizimit me energji elektrike.

ii) Me gjeneralitetet N. H. H. nuk rezulton ndonjë abonent;

iv) Me gjeneralitetet H. H. H. nuk rezulton ndonjë abonent, ndërsa me gjeneralitetet H. H., pa emër babai, rezultojnë 18 abonentë. E pyetur gjatë procesit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se vjehri i saj, z. H. H., nuk disponon kontrata të furnizimit me energji me FSHU-në, duke paraqitur shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 21.7.2021, të FSHU-së, sipas së cilës shtetasi me gjeneralitetet H. H. H. nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike me FSHU-në.

Nuk u konstatuan problematika e dyshime nga të dhënat e administruara nga FSHU-ja.

81. Nga të dhënat e sistemit *TIMS* rezulton se subjekti dhe familjarë të saj kanë udhëtuar me automjetet me targat si vijojnë: ***, ***, ***, ***, ***, ***. E pyetur në lidhje me pronarët e këtyre automjeteve, marrëdhëniet me ta dhe qëllimin e udhëtimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 subjekti ka dhënë sqarime të hollësishme. Pas verifikimit në sistemin AMF, rezultoi se deklaratimet e subjektit përputhen me të dhënat e policëmbajtësit, ndërsa nga verifikimet e kryera në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi⁶⁹ apo përfshirjeje në veprimtari të krimi të organizuar⁷⁰ nuk rezultuan të dhëna.

82. Nga verifikimi në RNSH⁷¹, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. N. H., u evidentuan dy veprime noteriale të llojit “deklarata me përmbajtje të tjera” të vitit 2014: akt noterial nr. ***, datë 12.6.2014 dhe akt noterial nr. ***, datë 13.11.2014. Pas kërkesës së Komisionit, noterja G. B. vuri në dispozicion⁷² të Komisionit këto dy akte noteriale, të cilat janë, përkatësisht, deklarim për lejimin e udhëtimit të fëmijës dhe deklarim se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk është i punësuar në asnjë subjekt publik apo privat.

Analiza financiare

83. Në përfundim të hetimit administrativ, me ndihmën e Njesisë së Shërbimit Ligjor, është kryer analiza financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit për të justifikuar me të ardhura të ligjshme, pasuritë dhe shpenzimet e kryera gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, përmbledhur në tabelën në vijim, ku duket se pamundësia e subjektit (shuma e viteve me

⁶⁹Shihni shkresat kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.8.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe nr. *** prot., datë 6.8.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

⁷⁰Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 3.8.2021, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

⁷¹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 8.5.2020, nga Ministria e Drejtësisë, në dosjen e Komisionit.

⁷²Shihni aktet e dërguara nga noterja G. B., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 6.8.2021, në dosjen e Komisionit.

balancë negative), në përfundim të hetimit administrativ, ka qenë në total në shumën 10.821.190 lekë.

Pasi janë marrë në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit, pamundësia totale e subjektit, gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit është në shumën 7.350.904 lekë, pasqyruar si në tabelën në vijim, e cila vjen kryesisht për shkak të mospërfshirjes si e ardhur e ligjshme e shumës së huas prej 60.000 euro.

0	1	2	3	4	5	6
Përshkrimi	Pasuri	Detyrime	Pasuri <i>neto</i> (1-2)	Të ardhura	Shpenzime	Mundësia për kursime (4-5-3)
2004	0	0	0	1 658 766	472 382	1 186 384
5005	10 081	0	10 081	1 573 630	501 162	1 062 387
2006	599 332	0	599 332	1 490 023	355 220	535 471
2007	793 792	0	793 792	1 629 387	439 380	396 215
2008	948 417	0	948 417	1 840 366	386 097	505 851
2009	1 199 855	0	1 199 855	2 022 487	447 118	375 514
2010	8 734 638	0	8 734 638	2 149 098	765 364	-7 350 904
2011	377 586	-829 800	1 207 386	2 122 309	708 261	206 663
2012	503 410	-838 320	1 341 730	2 092 770	663 840	87 199
2013	392 889	-1 402 100	1 794 989	2 856 667	598 435	463 243
2014	-11 255	-840 660	829 405	1 860 182	967 836	62 942
2015	122 212	-550 000	672 212	1 615 575	917 429	25 935
2016	-646 966	-1 096 000	449 034	1 772 721	1 189 220	134 467

Metodologjia e përdorur për analizën financiare

84. Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, duke krahasuar në çdo rast informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore me deklaratimet e subjektit. Kjo analizë është kryer duke marrë në konsideratë:

84.1. Të ardhurat

Subjekti është analizuar së bashku me bashkëshortin dhe fëmijët e saj, nga shkurt 1996 kur subjekti ka ushtruar detyrën e ndihmës gjyqtare e në vijim dhe, për rrjedhojë, në analizën financiare janë konsideruar të ardhurat e dokumentuara nga punësimi si vijon:

- pagat e subjektit nga data e fillimit të punësimit të saj si ndihmës gjyqtare dhe kancelare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër për periudhën shkurt 1996 – 16.3.2004, kur subjekti është

emëruar gjyqtare e deri në fund të periudhës së rivlerësimit dhe paga si pedagoge në universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës⁷³;

- të ardhurat nga paga e bashkëshortit duke filluar nga gushti i vitit 1995 deri në fund të periudhës së rivlerësimit⁷⁴, si dhe dëmshpërblimi i tij nga Autoriteti Shqiptar Rrugor⁷⁵;

- të ardhurat nga pensionet e prindërve të bashkëshortit, pasi gjatë gjithë kohës ata kanë jetuar me subjektin dhe familjen e saj⁷⁶;

- të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Peshkopi për vitin 2012⁷⁷.

84.2. Shpenzimet

- Shpenzimet e jetesës janë përlogaritur si vijon: deri në vitin 1999 si 50% e të ardhurave familjare; pas vitit 2000 në bazë të standardit të ILDKPKI-së për shtatë persona. Për shkak të konsiderimit të të ardhurave në natyrë nga toka bujqësore, shpenzimet e jetesës janë reduktuar me shportën e produkteve ushqimore të përlogaritura nga INSTAT-i dhe, konkretisht, për vitet 2000 – 2007 është zbritur përqindja e grupit “ushqim” (pa përfshirë pijet alkoolike) sipas anketës së buxhetit të familjes⁷⁸ dhe për vitet 2008 – 2010 është zbritur përqindja e grupit “për ushqim” sipas anketës së matjes së nivelit të jetesës⁷⁹.

- Shpenzimet e udhëtimit janë bazuar në raportin e sistemit *TIMS* dhe në sqarimet të dhëna nga subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ. Metodologjia e përlogaritjes së këtyre shpenzimeve është ajo e përcaktuar në vendimin (JR) nr. 11, datë 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

- Shpenzimet e mobilimit janë konsideruar sipas deklarimeve të subjektit në pyetësin standard.

- Është përfshirë çdo shpenzim i evidentuar gjatë hetimit administrativ, i administruar në dosjen e Komisionit dhe ILDKPKI-së.

84.3. Pasuritë

- Është përfshirë automjeti i blerë nga bashkëshorti i subjektit në vitin 2009 sipas vlerës së kontratës së shitjes.

- Apartamenti me sip. 102.4 m², në Tiranë, blerë në vitin 2010, sipas kontratës së shitjeve dhe pagesave të dokumentuara të çmimit të blerjes.

- Likuiditetet janë trajtuar si pjesë e pasurive në një zë të veçantë. Këtu janë përfshirë gjendjet e llogarive bankare⁸⁰ në fund të çdo viti/date të analizuar dhe gjendjet *cash* sikurse janë

⁷³Vërtetimet: nr. ***, datë 3.10.2016 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër për periudhën shkurt 1996 - 15.10.2011; nr. ***, datë 23.1.2020 dhe nr. *** prot., datë 23.1.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 11.11.2010 – 31.12.2016 si dhe vërtetim për vitin 2011, nga universiteti “Aleksandër Moisiu”.

⁷⁴Vërtetimet: nr. ***, datë 25.10.2016, nga Qarku Dibër për periudhën e punësimit 16.8.1995 - 31.7.1996; nr. *** prot., nga DRT-ja Dibër për periudhën e punësimit 1.8.1996 - 20.9.2001; nga DRISSH-ja Dibër për pagesën e asistencës sociale për periudhën shtator 2001 - shtator 2002; nr. *** punonjës nga ATK-ja për periudhën shtator 2002 – 2006.

⁷⁵Vendimi nr. ***, datë 4.3.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe urdhër shpenzimi nr. ***, datë 9.9.2013, i Autoritetit Rrugor Shqiptar, verifikuar me lëvizjet e BKT-së.

⁷⁶Shkresat nr. *** prot., datë 25.10.2016 dhe nr. *** prot., datë 14.10.2016, nga ISSH-ja për pensionin e pleqërisë së vjehrrit H. H. dhe vjehrrës N. H., nga viti 1991 deri në fund të viti 2016.

⁷⁷Kontratë qiraje për periudhën 5.1.2012 - 31.12.2012 dhe shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2017, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, sipas së cilës në datën 10.1.2017 është paguar tatimi mbi qiranë në shumën 45.000 lekë.

⁷⁸http://www.instat.gov.al/media/2067/buxhetin_i_familjes

⁷⁹http://www.instat.gov.al/media/2063/anketa_e_matjes_se_nivelit_te_jeteses_2008

⁸⁰Shkresat: nr. *** prot., datë 18.5.2020, nga “Intesa Sanpaolo Bank”; nr. *** prot., datë 6.5.2020, nga “Raiffeisen Bank”; nr. *** prot., datë 13.5.2020, nga BKT-ja; nr. *** prot., datë 22.9.2020, nga “Credins Bank”.

deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, në DPV-të ndër vite, si dhe sqarimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit.

- Ndryshimi i likuiditeteve, pakësimi ose shtesa nga viti në vit, është pasuria e krijuar nga subjekti për çdo vit.

- Shuma e pasurive dhe likuiditeteve përbën totalin e pasurisë së akumuluar nga subjekti, nga fillimi i detyrës deri në fund të periudhës së vlerësimit.

84.4. Detyrimet

- Shlyerjet e huas ndaj kunatit P. H. sipas deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike vjetore për vitet 2011 – 2016.

84.5. Pasuria *neto* është diferenca e pasurisë me detyrimet.

84.6. Rezultati financiar është i përlogaritur për çdo vit, për çdo datë/periudhë të krijimit të pasurisë/ve, si dhe në total.

84.7. Mundësia për kursime rezulton si shumatore e të ardhura (shpenzime + pasuri neto), për çdo vit dhe për të gjithë periudhën e rivlerësimit.

Vlerësimi përfundimtar në lidhje me kriterin pasuror

85. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë u vërtetua se subjekti i rivlerësimit Irena Hoxha:

i) ka kryer deklarime të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me ligjin (germa “a”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016);

ii) ka mungesë të burimesh të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, për shkak balancës negative në shumën 7.350.904 lekë (germa “d”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016).

Për sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet pikës 5, të nenit 33, të këtij ligji, që përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Kontrolli i figurës

86. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Irena M. Hoxha, i deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë 10.9.2021, të KDZh-së, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga subjekti në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e saj apo për kontakte të papërshtatshme me persona të

përfshirë në krimin e organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Irena M. Hoxha*.

Gjatë hetimit administrativ, pas kërkesës së Komisionit për përditësim të dhënash, DSIK-ja me shkresë konfidenciale ka përcjellë shkresën e SHISH-it sipas te cilës nuk ka të dhëna shtesë.

87. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk evidentoi fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të cilat do të ndryshonin konstatimin fillestar të Grupit të Punës të DSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit Irena Hoxha, është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

Vlerësimi i aftësive profesionale

88. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Irena Hoxha, bazuar në: (i) raportin për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 13.9.2021; (ii) informacioni i marrë nga burime të tjera; si dhe (iii) kriteret e vlerësimit sipas ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga KLGj-ja

89. Analiza e kryer prej KLGj-së, në vlerësimin e aftësive profesionale, është bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit; (ii) tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dokumente ligjore të përzgjedhura, sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së, sipas të cilave gjatë ushtrimit të detyrës së gjyqtarës nuk ka pasur asnjë procedim disiplinor dhe nuk është marrë asnjë masë disiplinore, ndërsa rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Irena Hoxha janë paraqitur gjithsej tri ankesa të vitit 2016, të cilat janë arkivuar.

90. KLG-ja, pasi ka analizuar të dhënat si më sipër, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit, si vijon:

90.1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Irena Hoxha ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit dhe identifikon normën ligjore të zbatueshme, si dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ka njohuri për parimet e përgjithshme të së drejtës dhe i përdor ato në procedurën e gjykimit, siç janë e drejta e mbrojtjes, apo parimi i interesit më të lartë të fëmijës dhe sipas rastit i analizon dhe shprehimisht në tekstin e vendimeve. Nga dokumentet e vëzhguara nuk u evidentua të jetë ankimuar ndonjë vendim nga palët ndërgjyqëse.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Irena Hoxha ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të qarta dhe të kuptueshme. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit

ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, si dhe rekomandimeve të psikologëve të thirrur në gjykim. Niveli i arsytimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

90.2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas germës “d”, të pikës 3, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, i dhomës civile i seksionit familjar, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje familjare. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore, prej jo më pak se 600 gjykime, çështjesh të tilla për tre vjet. Ngarkesa e saj sasiore ka qenë dukshëm mbi standardin minimal. Subjekti i rivlerësimit Irena Hoxha e respekton kohën në gjykim, si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, si dhe i kushton rëndësi kohës së arsytimit të vendimeve gjyqësore.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje menjëherë me marrjen e akteve të çështjes me short, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore. Distancat kohore midis seancave janë të arsyeshme dhe në raport me shkallën për të cilin seancat janë shtyrë. Gjyqtarja zhvillon dhe dokumenton procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtarja ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore.

90.3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë. Përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

b) Integriteti

Nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Irena Hoxha. Për gjyqtaren Irena Hoxha në asnjë prej dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

90.4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Gjyqtarja Irena Hoxha komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore, si dhe ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje profesionale dhe etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit Irena Hoxha për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Në periudhën e rivlerësimit, gjyqtarja Irena Hoxha ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 22 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

Informacioni i marrë nga burime të ligjshme si vijon:

91. Informacioni i marrë nga tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave rezultuan të njëjtat gjetje të konstatuara edhe nga KLGJ-ja në raportin e saj. Ndërkohë, në lidhje me tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, konkretisht vendimi nr. ***, datë 15.10.2015, vendimi nr. ***, datë 15.4.2016 dhe vendimi nr. *** datë 15.7.2016, duke qenë se nga aktet e paraqitura nuk evidentohet nëse ishin ankimuar nga palët, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë informacion të mëtëjshëm nëse ndaj tyre është ushtruar ankim për vendimmarrjen përkatëse.

92. Në parashtrimet e saj, subjekti ka informuar se: (i) vendimi nr. ***, datë 15.10.2015, nuk është ankimuar nga palët dhe ka marrë formë të prerë; (ii) vendimi nr. ***, datë 15.4.2016, është ankimuar nga pala e paditur, por pala ankimuese ka hequr dorë nga ankimi pushimi i shqyrtimit të çështjes; (iii) vendimi nr. ***, datë 15.7.2016, është ankimuar nga pala e paditur dhe Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të tij. Nuk rezultuan paqartësi të mëtëjshme në lidhje me këto dokumente dhe, për rrjedhojë, nuk kanë qenë të domosdoshme hetime të mëtëjshme.

93. Informacioni i marrë nga 6 (gjashtë) denoncime të paraqitura nga publiku sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, në 5 prej ë cilave⁸¹ pretendimet e denoncuesve lidheshin me vendimmarrje të padrejtë të subjektit të rivlerësimit, vlerësimi i të cilave në zbatim të nenit të nenit 72/4, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është jashtë tagrit të vlerësimit të Komisionit.

Komisioni thelloi hetimin administrativ në tre denoncimet e shtetasit E. A.⁸². Në letrën e tij “informacion në ndihmë të reformës në drejtësi”, ky shtetas jep informacion për shkëlje të kryera nga disa gjyqtarë, ndër të cilët edhe për subjektin Irena Hoxha. Për këtë subjekt denoncuesi ngre pretendime për zvarritje të çështjes që i përket mbesës së tij, znj. M. A., lidhur

⁸¹Shihni denoncim nga shtetasja A. L., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.12.2017; denoncim nga shtetasja D. K., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 6.3.2018; denoncim nga shtetasit D. dhe I. L., protokolluar në Komision me nr. ***, datë 9.5.2018; denoncim nga shtetasi A. Ll., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 25.7.2019; denoncim nga shtetasi A. Sh., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 7.7.2021, në dosjen e Komisionit

⁸²Shihni informacion nga shtetasi E. A., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.9.2019; shihni denoncim nga shtetasi E. A. protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.9.2018; shihni denoncim nga shtetasi E. A., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.9.2018, në dosjen e Komisionit.

me pjesëtimin e një pasurie pas divorcit, për të cilën informon se vijon akoma edhe në momentin e paraqitjes së denoncimit të tij.

94. Me qëllim vlerësimit e çështjeve të ngritura nga denoncuesi, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan sqarime mbi pretendimet e denoncuesit, duke paraqitur sqarime dhe dokumente shkresore.

95. Në parashtrime subjekti ka dhënë sqarime mbi hapat procedurale në trajtimin e kësaj çështjeje dhe ka paraqitur disa akte nga dosja gjyqësore, nga analizimi i të cilave konstatohet se: (i) shtetasja M. A. në datën 11.4.2018, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi me objekt “pjesëtim i pasurisë së përbashkët”, çështje që i ka rënë për shqyrtim gjyqtarës Irena Hoxha; (ii) në datën 18.4.2018, gjyqtarja Irena Hoxha ka marrë vendim të ndërmjetëm për plotësimin e të metave të padisë, sikurse janë provat mbi të cilat bazohet padia, përcaktimi i dëshmitarëve, ekspertime të mundshme, si dhe adresa e saktë e të paditurit, të cilat duhet të plotësohen brenda afatit 10-ditor; (iii) me vendimin nr. ***, datë 20.6.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur t’i kthejë aktet e padisë ankueses M. A., sepse nuk ka qenë i mundur njoftimi i të paditurit, për shkak të adresës së pasaktë; (iv) kundër këtij vendimi, ankuesja ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 20.4.2019, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 20.6.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin për rishqyrtim, në po atë gjykatë, me të njëjtin trup gjykues. Sipas Gjykatës së Apelit Tiranë, në kushtet kur njoftimi i të paditurit A. M. ka qenë i pamundur të realizohet nga gjykata, duhej të ishte proceduar me njoftimin me shpallje në baza të nenit 133 të Kodit të Procedurës Civile; (v) pas rishqyrtimit në themel të padisë së ankueses, si dhe bazuar në detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 20.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur rrëzimi i kërkesëpadisë së pjesëtimin të pasurisë bashkëshortore, si e pabazuar në ligj dhe në prova; (vi) shtetasja M. A. i është drejtuar me ankesë edhe ILD-së, institucionin i cili pas analizimit të çështjes me vendimin nr. *** prot., datë 21.4.2021, ka vendosur arkivimin e ankesës.

97. Në analizë të akteve të mësipërme, në procesin e vlerësimit përfundimtar, nga Komisioni u konstatuan shkelje të natyrës procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit në trajtimin e çështjes, ashtu sikurse është evidentuar edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë në vendimin nr. ***, datë 25.4.2019, duke arsyetuar se në kushtet kur njoftimi i të paditurit A. M. ka qenë i pamundur të realizohet nga gjykata, duhej të ishte proceduar me njoftimin me shpallje në bazë të nenit 133 të Kodit të Procedurës Civile.

98. Pavarësisht shkeljes së evidentuar, duke mbajtur në konsideratë faktin se kjo nuk është një shkelje e përsëritur nga subjekti, si dhe faktin që nga institucioni kompetent ILD-ja nuk është proceduar me marrjen e ndonjë mase disiplinore, Komisioni vlerëson që problematika e kësaj çështjeje është e pamjaftueshme për ta konsideruar subjektin me mangësi profesionale. Për më tepër, në zbatim të pikës 1, të nenit 42 dhe nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, vlerësimi përfundimtar, lidhur me secilin prej kritereve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, duhet të jetë produkt i vlerësimit tërësor të burimeve të përcaktuara në ligj dhe jo i bazuar në një burim të vetëm vlerësimi dhe aq më pak të një çështjeje të vetme⁸³.

⁸³Shihni vendimin nr. 11 regjistër (JR), nr. 25 i vendimit, datë 1.10.2020, paragrafi nr. 114, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Rivlerësimi profesional sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

99. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni vlerësoi se:

- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale, sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, parashikuar nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016.

100. Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

IV. SEANCA DËGJIMORE

101. Në datën 6.10.2021, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Irena Hoxha, në përfundim të së cilës, kërkoi konfirmimin në detyrë. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e saj, duke dhënë sqarime të mëtjshme mbi rezultatet e hetimit administrativ, procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, si dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të drejtuar nga anëtarët e trupit gjykues. Në datën 8.10.2021 u zhvillua seanca, në të cilën Komisioni shpalli vendimin për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Irena Hoxha.

V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

102. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjatë seancës dëgjimore. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë i gatshëm dhe bashkëpunues, duke u përgjigjur me korrektesë dhe brenda afateve të caktuara pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

VI. KONKLuzion PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjatë bisedimeve për vlerësimin përfundimtar të çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe në qëndrimin e subjektit të rivlerësimit për çdo çështje, rast pas rasti, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Irena Hoxha nuk arrin nivelin kualifikues, për sa i takon kriterit të pasurisë, pasi ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme, sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra,

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Irena Hoxha, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 8.10.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Firdes SHULI
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi